

FATOS KONGOLI

**NJERIU ME FAT**

R O M A N

---

BOTIMET TOENA

*Çdo ngjashmëri me persona dhe ngjarje reale është e rastit.  
Gjithçka në këtë libër është prodhim i fantazisë.*

AUTORI

FATOS KONGOLI

# NJERIU ME FAT

ROMAN

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2013

Botuese: Irena Toçi  
Korrektore letrare: Arlinda Rrushi  
Përkujdesja grafike: Albana Kura  
Kopertina: Lavdie Cenmurati

© Autori *dhe* Shtëpia Botuese Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K.Postare 1420, Tiranë

Tel.: ++355 4 22 40 116; ++355 22 58 893

Tel./Fax: ++355 4 22 40 117

E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

# 1

*I*nspektori Sabit Kurti mezi po e shtynte javën e fundit të muajit gusht, në pritje të shtatorit. Sipas një marrëveshjeje me shefin e departamentit, në shtator do ta lejonin të dilte në pension. Ai duhej të kishte dalë ose duhej ta kishin nxjerrë në pension prej kohësh. Ishte më i vjetri në shërbim, kolegët e dikurshëm, për arsye nga më të ndryshmet, qenë larguar ose i kishin larguar njëri pas tjetrit. Ndërsa ai, në pritje që ta largonin ose nxirrnin në pension, vazhdonte të ulej në të njëjtën karrige, në të njëjtën zyrë, para të njëjtës tryezë, mbi të cilën mbante një fotografi të bashkëshortes. Katër vjet të shkuara ajo kishte vdekur nga një sëmundje e rëndë.

Tashmë ai vinte në zyrë kot, mund edhe të mos vinte, largimi i tij qe bërë fakt i kryer. Mirëpo ashtu si gjatë njëzet vjetëve të fundit, aq sa kishte në shërbim pas një karriere prej pedagogu matematike, çdo mëngjes ai paraqitej në zyrë, me të njëjtën përpikëri, zinte vend pranë tryezës dhe, meqë askush nuk i kërkonte llogari dhe, anasjelltas, nuk i jepte më llogari askujt, nuk i mbetej gjë tjetër veç të shtynte orët. Kur nuk shkonte në një kafene aty afër - i pashoqëruar, prania e kujtdo qoftë e bezdiste - një pjesë të tyre i kalonte me sportin e tij të vjetër, merrej me zgjidhje integrale. Gjithsesi, vinte një çast që mërzhitej, i hipte të largohej nga zyra. Nëse nuk shkonte te kafeneja aty afër, ku e njihnin, shkonte diku tjetër, me shpresë të mos njihej nga askush. Këtë veprim të fundit e kryente gjithnjë e më rrallë, s'donte ta linte vetëm bashkëshorten. Dhe vështrimin e përqendronte te fotografia me portretin e saj.

Midis tyre zhvillohej e njëjta bisedë, ajo kërkonte të mësonte të rehat e fundit, ai përpiquej t'i shuante kureshtjen. Gruaja ankohej, nga shpjegimet e tij nuk mësonte asgjë të re, si gjithmonë ai ia fshihte të vërtetat. Ai as ia ushqente këtë mendim, as ia kundërshtonte, në të dyja rastet biseda do të ndërlikohej. Mund t'i pohonte ndoshta një të vërtetë: në këtë botë nuk ndodhte asgjë e re, gjithçka përsëritej në një formë tjetër, të

stërnjohur, siç përsëriteshin e ripërsëriteshin jeta dhe vdekja. Këtë fakt, tani që ndodhej në botën tjetër, me siguri në parajsë, ajo duhej ta dinte më mirë se ai, tradhtari, përderisa nuk kishte qenë i aftë ta shoqëronte në udhëtimin e fundit. Por burri pëlqente më mirë të heshte duke u zhytur në sytë e saj, sesa t'i përralliste gjepura.

Zilja e telefonit mbi tryezë tringëlli pikërisht kur ai ishte zhytur në sytë e bashkëshortes me një lutje për mirëkuptim që nuk ishte në gjendje t'ia plotësonte si duhet kureshtjen e të rejave të kësaj bote. Telefonatat në drejtim të tij ishin bërë të rralla dhe thirrja i erdhi aq e beftë, sa gati u tremb. Pa e hequr vështrimin nga sytë e bashkëshortes ngriti receptorin, e vuri në vesh dhe nga ana tjetër i mbërriti një zë i njohur: shefi i departamentit. Ai e ftoi të shkonte në zyrën e tij, mbyturazi, pa i dhënë ndonjë shpjegim, por zoti Kurti nuk gjeti asgjë të pazakontë në këtë mes. Zëri i tjetrit, çuditërisht i ngjashëm me zërin e të gjithë shefave pararendës, gjashtë gjithsej në njëzet vjet, ishte gjithmonë si i mbytur, ndërsa çdo shpjegim, i tepërt. Kuptohej, tjetri e kërkonte për hollësitë e daljes në pension. Këtë i tha edhe bashkëshortes, i duhej të largohej. Më në fund shefi po e thërriste për punën e daljes në pension.

U rikthye në zyrë pas gjysmë ore. Një copë herë qëndroi i ulur në karrige, përballë

portretit të bashkëshortes, i pavendosur nëse ia vlente t'ia tregonte edhe asaj bisedën e tyre.

“Punë dreqi, - mërmëriti qejfprishur, - duket, dalja ime në pension nuk mund të mbyllej ndryshe përveçse me një episod, që shefi, të cilin ti nuk arrite ta njihje, ai erdhi pas ikjes tënde, e cilësoi grotesk. Në zhargonin e tij kjo do të thotë ‘i pabesueshëm’. Interesante përse shefi im i gjashtë kuptimin ‘grotesk’ e barazon me kuptimin ‘i pabesueshëm’! Do t'ia vlente ta diskutonim pak, por s'jam hiç në formë. Në këtë sezon një pjesë e kolegëve janë me pushime, ata që mbeten të zënë me punë të tjera dhe personi më i përshtatshëm për sqarimin e çështjes para se të tërhiqem nga detyra, mbetem unë. Kështu u shpreh ai, me fjalët ‘të tërhiqem nga detyra’ dhe jo ‘të dal në pension’. Sipas tij, për një specialist si unë nuk mund të ketë dalje në pension dhe, Zot na ruaj, do të jem i nevojshëm këtu derisa të vdes.

“Më vjen keq, nuk i thashë jo, dhe mora përsipër një angari të fundit. Është fjala për një vrasje, pritet të ndodhë një vrasje. Jo e zakonshme, do të vritet një VIP... Meqë shefi e quante grotesk informacionin, domethënë të pabesueshëm, nuk dukej dhe fort i shqetësuar. ‘Hedh një budalla një gur në ujë dhe mblidhen njëqind të mençur e nuk e nxjerrin dot,’ - tha ai. Unë do të jem në rolin e atij që i duhet të nxjerrë nga uji gurin e budallait!”



Inspektori u shkëput nga portreti i së shoqes. Nuk deshi që ajo të merrte vesh se sa i pakënaqur ndihej, ja ngaqë edhe në ditët e mbetura s'po e linin rehat, ja ngaqë në çastin e fundit, në vend të mospranimit për t'u marrë me çka i propozohej, ai qe mbyllur në një heshtje kontradiktore. Tek dëgjonte shpjegimet e shefit, i qenë rizgjuar ca vatra të vjetra, pavarësisht elementëve karikaturë të historisë, ku binte në sy sidomos një fakt. Informacioni vinte nga një burim në diasporë, me pseudonimin "Shifra", një informator vullnetar. Ky ishte elementi i parë karikaturë.

Pseudonimi "Shifra" nuk ishte i panjohur për inspektorin, kështu quhej një personazh mafioz në një nga filmat e serisë me Xhejms Bond. Rastësia deshi që ai ta shihte CD-në me këtë film, dhuratë e një kolegu, pikërisht kur në departamentin e tyre pluskoi informatori vullnetar, të cilin nuk i kujtohej se kush, ndoshta vetë kolegu i tij, e kishte pagëzuar thjesht për t'u zbavitur me emrin e koduar "Shifra". Çfarëdo që të ishte, sharlatan apo i sëmurë psikik, ai jepte dy të dhëna, jo aq të papërfillshme. Kohën e kryerjes së krimit, dhjetëditëshi i parë i muajit shtator. Dhe vendin e krimit, të përcaktuar saktësisht - këtu ndërfaqej elementi i dytë karikaturë - hoteli "Elsinor" diku në bregdet. Muaji shtator po trokiste ndërsa hoteli "Elsinor" ishte atje.

Me gjithë dyshimet dhe mungesën e dëshirës - më shumë të nervave - për t'iu rikthyer një bote së cilës ngutej t'i largohej, zoti Kurti iu nënshtrua instinktit, të zhytej për të nxjerrë nga uji gurin e budallait. Ky vërtet nuk jepte as emrin e vrasësit, as viktimën, për këtë të fundit thuhej se qenkej një VIP, e kjo e ngatërronte punën. Aktualisht kategoria e VIP-ave shtrihej që nga këngëtarët e këngëtarët e klubeve të natës, folëset apo folësit televizivë, deri te politikanët e lartë, gjithandej përballëshe me VIP-a. Një ekuacion me shumë të panjohura, njëlloj si të kërkoje gjilpërën në një mullar me kashtë. Mirëpo Shifra jepte kyçin e zgjidhjes, vendin e krimit, hotelin "Elsinor". Në një nga ditët apo netët e dhjetëditëshit të parë të shtatorit atje, e njihnin apo nuk e njihnin njëri-tjetrin, do të përballëshin të dy, vrasësi dhe viktima.

Shifra mund ta dinte, mund edhe të mos e dinte se ç'përfaqësonte fjala "Elsinor", pra që kështu Shekspiri ka quajtur një kështjellë mesjetare në Danimarkë, sot e kthyer në hotel, kështjellën Kronborg, në breg të detit, ku vendos ngjarjet e tragjedisë "Hamleti". Zotit Kurti nuk i hynte në punë niveli i tij kulturor. Ai njihte mirë diçka tjetër, e kjo ia ngriti mendjen qysh në fillim. Njihte legjendën e hotelit karikaturë "Elsinor", diku në bregdetin shqiptar.

“Vend simbolikisht ideal për kryerjen e një krimi, - i tha bashkëshortes, - po kush të jetë VIP-i i shënjuar?”

*P*rej disa kohësh Gentian Engjëlli u shmangej daljeve publike me bashkëshorten, përveç ndonjë rasti special, fjala vjen kur i biri, gati për të hyrë në klasën e parë fillore, u kërkonte ta shoqëronin të dy bashkë në ndonjë shëtitje. Atë mbrëmje, e fundit e muajit gusht, rasti ishte tepër special. Në hotelin “Sheraton”, presidenti i të ashtuquajturit “Astra Group”, që zotëronte kompaninë pioniere dhe më të madhe të ndërtimit në vend, një fabrikë për prodhimin e detergjenteve dhe aktivitete të tjera, festonte shtatëdhjetëvjetorin e lindjes. Njëherazi do të njoftonte largimin nga drejtimi i punëve, do të shpallte zëvendësin, e ky qe djali i madh i bosit, një burrë rreth të dyzet e pesave.

Atij nuk i interesonte as shtatëdhjetëvjetori i njeriut të fuqishëm, as caktimi i trashëgimitarit të fronit. Tjetër gjë se askush nuk do të kujtohej për të sikur bashkëshortja e tij të mos kryente detyrën e përfaqësueses juridike të “Astra Group” dhe, falë saj, ai të futej automatikisht në numrin e të ftuarve të privilegjuar.

Sa për sqarim, bashkëshortja e tij, një grua rreth të tridhjetave, nuk kishte asgjë kundër shmangies së daljes së tyre bashkërisht në publik, dhe jo vetëm kaq. Prej disa kohësh, me këmbënguljen e saj ata nuk ndanin më të njëjtin shtrat, flinin në dhoma të ndryshme. Sipas një llogarie që bënte ai, kjo përkonte me ngritjen në përgjegjësi dhe caktimin e saj në postin e përfaqësueses juridike të “Astra Group”, dy vjet të shkuara. Atij i qe dashur njëfarë kohe që të bënte një lidhje midis ngritjes në përgjegjësi të bashkëshortes dhe këmbënguljes së saj për të mos ndarë me të të njëjtin shtrat, në të njëjtën dhomë. Dhe më në fund të kthjellohej, të vinte me këmbë në tokë, i pazoti të merrte një vendim, po të pranohet se vetëm shmangia e daljeve publike në çift, në rrethanën e dhënë nuk tingëllon aq bindëse sa të quhet “vendim”. Përkundrazi, të krijojë te të tjerët përfytyrimin e një personi të dobët që përpiket të fshihet pas gishtit, apo të strucit, i cili - të paktën kështu thuhet - kur e sheh veten keq fut kokën në rërë, me ndjesinë se bëhet i padukshëm.

“Asgjë e jashtëzakonshme, - do të komentonte inspektori Kurti. - Një anekdotë e lashtë, që përsëritet e ripërsëritet brez pas brezi, në një numër të pafund formash të ndryshme. Duket, - do të vazhdonte ai, - qysh pas rënies së matriarkatit, kur femrat e humbën sundimin në marrëdhëniet njerëzore, ato kanë vendosur t’i kundërvihen përjetësisht kësaj padrejtësie”. Dhe jo pa një lloj druajtjeje për shkak të ndonjë keqkuptimi të mundshëm, do të shtonte: “Po t’i besosh Engelsit - për ata që nuk ia kanë dëgjuar emrin, shënoj se është një filozof gjerman i shekullit XIX, i diskredituar në trevat e arbrit për më se katër dekada radhazi në gjysmën e dytë të shekullit XX - hakmerren ndaj pushtetit të mashkullit në trajtën më lënduese për sedrën e tij, e tradhtojnë. Ose, në gjuhën e bukur metaforike shqipe, ia dredhin.”

Mirëpo, hëpërhë inspektori nuk ka as idenë se në këtë botë, ku çdo gjë përsëritet e ripërsëritet, ekziston një individ i quajtur Gentian Engjëlli. Rasti i këtij të fundit, megjithëse i ngjashëm me një numër pambarimisht të madh rastesh pararendëse, ka disa veçanësi, me ngjyrim lokal. Nisur nga ky fakt dhe nga natyra traumatike e tij, me ndikime të paparashikueshme në sjelljen e individëve të ndryshëm - disa gjëra jo të gjithë i përjetojnë njëlloj - del e nevojshme të shpërngulemi në zanafillë, ta lëmë burrin

në sallonin e apartamentit, ku po rri në pritje të bashkëshortes. Kjo, mosbesuese ndaj pasqyrës, e ka të vështirë të ndahet prej saj. Kërkon me çdo kusht të bindet se nuk i mbetet asgjë për t'i shtuar një tualeti të mirëllogaritur, e të shkojë në ceremoninë solemne me një dukje sa më të përkryer si femër, por edhe si përfaqësuese juridike e një ngrehine të fuqishme.

Hëpërhë, pra, t'i lëmë burrë e grua atje ku janë, të ngjirë, shtatore anonime prej dylli. Të lëmë edhe një shenjë, një tabelë. Si ai udhëtari që futet në një pyll të panjohur, dhe tek shkon në thellësi, lë prapa vetes ca shenja, për të mundur të kthehet në pikën e nisjes. Mbi tabelë po shënojmë konvencionalisht fjalët: “Prag ceremonie”. Kështu, s'ka rrezik të ngatërrohemi, dhe burrë e grua t'i gjejmë sërish atje ku i lamë.

Dy vjet të shkuara ai e kishte pranuar pa fjalë propozimin e bashkëshortes për të fjetur veç e veç dhe kushtet nuk u mungonin. Në apartamentin e tyre të ri, në një pallat të ndërtuar nga “Astra Group”, në një nga zonat më të gjelbra të kryeqytetit, jo fort larg hotelit “Sheraton”, vetëm pak minuta në këmbë, njëra nga dhomat, e planifikuar si dhomë miqsh, ishte e pajisur me të gjitha orenditë e nevojshme të një dhome gjumi. Arsyeja që i paraqiti bashkëshortja për këtë ndryshim

rrënjësor në jetën e tyre, iu duk bindëse. Ai gërhiste, tashmë këto gërhima asaj i ishin bërë të padurueshme.

Gentian Engjëlli, rreth tridhjetë e pesë vjeç, pedagog i gjuhës frënge në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe përkthyes me të ardhme, siç e cilësonin, ia njihte vetes këtë cen. Çfarë nuk kishte bërë për të shpëtuar prej tij! Qe këshilluar me mjekë, edhe në Paris, gjatë një specializimi nëntëmujor, pa dobi. Intensiteti i gërhimave i qenkej rritur më tej në mënyrë dramatike, nuk mbetej gjë tjetër veç të shtrihej për të fjetur vonë, shumë vonë, pasi gruan e zinte gjumi. Mirëpo kjo e paskej gjumin të lehtë, zgjohej befasi në mes të natës: “Më çmende”, - i ankohej, derisa dy vjet të shkuara propozimin e saj për të mos fjetur në të njëjtën dhomë e në të njëjtin shtrat, ai e gjeti të arsyeshëm.

Përgjithësisht ai ishte njeri me natyrë pozitive, mendja nuk i punonte për keq, një individ me *bonsens*, siç thuhet. Dhe kur e shoqja e njoftoi se tashmë nuk mbetej zgjidhje tjetër përveçse të flinin në dhoma të ndara - si çiftet aristokrate, kishte qeshur ajo - burrit nuk i shkoi mendja se prapa këtij propozimi mund të fshihej diçka. Po kështu, nuk kishte parë ndonjë të keqe as te favorët e Grupit ndaj bashkëshortes, kushtet me të cilat u qe dhënë apartamenti në pallatin e ri, në katin e gjashtë, si dhe gjyshes e gjyshit të saj nga i ati një



kat më poshtë, në këmbim të apartamenteve të tyre të vjetra me hapësira më të vogla, kundrejt një kompensimi monetar simbolik. Përkundrazi, në vend që t'i shkonte mendja për keq, natën e parë që iu desh të flinte jo me bashkëshorten, ai u përfshi nga një turbullim, një ndjesi prej fajtori dhe, në këtë kuptim, mendjet me plazmim të ndryshëm nga e tij, do ta quanin idiot.

Atë natë burrë e grua u kthyen vonë në shtëpi dhe para se të ngjiteshin në apartamentin e tyre, bënë një ndalesë te pleqtë. Jo për të qëndruar, ishte vonë për të qëndruar. Sa herë dilnin mbrëmjeve me rrezikun për t'u kthyer vonë, ata e linin djalin në shoqërinë e pleqve, të dy ende aq të mbajtur sa t'ua besonin të voglin. Ky qe një fëmijë i mbarë, i dëgjueshëm, kur vonoheshin si atë natë, e gjenin në gjumë. Ai e merrte me kujdes në krahë, për të mos e zgjuar; i pëlqente ta çonte vetë për të fjetur, dhe fëmija vazhdonte të rrinte tërë kohën me sytë mbyllur, derisa e mbulonte dhe i shuante dritën e dhomës.

Kështu, edhe atë natë, ai e mori djalin në krahë, e çoi në dhomën e tij të gjumit, e shtriu në krevat, i fiku dritën dhe u kthye në holl. Të shoqen nuk e gjeti aty. Si rregull, tani edhe ai duhej të ishte bashkë me të në dhomën e tyre, duke u zhveshur. Kur ajo mbetej vetëm me këmishë dhe shkonte në banjë për dush, do të thoshte se dëshironte të bënin dashuri, pra,

fill pas saj duhej të shkonte edhe ai në banjë për dush. Në të kundërt, ajo thjesht vishte një palë tuta dhe po të kishin ngrënë ndonjë gjë jashtë, zinin vend përpara televizorit. Ajo shihte pak televizor, i pëlqente më mirë të flinte, kështu që ngrihej, i thoshte “Natën!”.

Meqë nuk e gjeti të shoqen në holl, ai u ul në një nga kolltukët përballë televizorit, pa e ndezur. Ktheheshin nga një darkë e ngarkuar me verë. Në këto raste, me të mbërritur në shtëpi, ajo ngutej të futej në dush. Në përputhje me këtë, ai priti të ndiente hapat e saj për në banjë, çka do të ishte një ftesë kuptimplote atë natë kur, sipas marrëveshjes, do të flinin për herë të parë veç e veç.

Gjatë darkës së shtruar te restoranti i hotelit “President”, me kolegë e kolege të bashkëshortes, ndër ta një mashkull me emrin Bledar Pirgu, njëshi i ardhshëm i “Astra Group”, ajo i qe bërë shumë e dëshirueshme. As vetë nuk e kuptoi përse - ndoshta e ndezur nga vera gruaja po rrezatonte ca hire të panjohura për të, ndoshta ngaqë, siç po i dukej, të gjithë meshkujt e pranishëm i kishin sytë tërë kohën tek ajo, veçanërisht Bledar Pirgu, të cilit e shoqja i drejtohej herë pas here në intimitet, duke e thirrur thjesht me shkurtimin Bledi - ca nga ca, dëshira iu kthye në një ide të ngulmët. Në fund, rrugës për në shtëpi, tek ngiste makinën ngadalë, gjithë kësaj ai i vuri një emër: po vuante nga një ide e

ngulmët për ta poseduar bashkëshorten. Ose, duke iu bindur puritanizmit prej përkthyesi, vetvetiu, në mendjen e tij fjala “poseduar” u zëvendësua me fjalën “zotëruar”. Atë natë ai e ndjeu të domosdoshme ta zotëronte.

Më kot priti një copë herë të dëgjonte hapat e saj në korridor. Më kot priti që së paku ajo të vinte t'i thoshte “natën”. Doemos, asgjë nuk mund ta pengonte të shkonte në dhomën e gjumit, të futej në krevat, të ushtronte të drejtën e ligjshme të mashkullit ndaj gruas së ligjshme, ta zotëronte, edhe pse as ajo, as ai, nuk kishin bërë dush. Në vend të kësaj ai vazhdoi të rrinte në pritje ende me shpresën se dera e dhomës së tyre të gjumit do të hapej, gruaja do të shfaqej në sallon vetëm në këmishë, nëse nuk do të shkonte në banjë për dush, së paku të vinte t'i thoshte një “natën”.

Burri u bind, dëshira e tij e ngulmët për ta zotëruar të shoqen atë natë nuk do të realizohej. Megjithatë, mendja nuk i vajti për keq, po të mos quajmë të tillë një skenë imagjinare, një lloj halucinacioni aq i fortë, sa të nesërmen në mëngjes iu duk sikur kishte parë një ëndërr të keqe. Skena u zhvillua në trurin e tij afërsisht si më poshtë:

Në mes të natës, pa mundur të çlirohet nga vuajtja, ai lë krevatin. Del në korridor, përshkon majë gishtërinjve hollin e kredhur në gjysmë-errësirë dhe i drejtohet dhomës së tyre të gjumit, tashmë dhomë gjumi vetëm

e bashkëshortes. Pa u ndier, ul dorezën. Gjithnjë pa u ndier e gjithnjë majë gishtërinjve, futet brenda, mbyll derën pas vetes. Ajo është atje, shtrirë në krevat, përmbys, me kokën mbi jastëk, të kthyer anash. Një dritësim i dobët futet përmes dritares, luan me pjesët e zbuluara nën çarçaf të trupit të gruas dhe ai zë vend në krevat, me fytyrën shumë pranë fytyrës së saj, e puth lehtëazi. Atëherë gruas i del gjumi. “O Zot!”, - gati klith ajo e trembur, por ai nuk i lë kohë të kuptojë ç’po ndodh; është i errur dhe e përfshin me të dyja krahët, e vë poshtë. Gruaja përpëlitet, e kundërshton, e shtyn, kërkon të çlirohet, mënjanon fytyrën sa në një anë në tjetrën që ai të mos mund ta puthë e, sa më shumë kundërshton ajo, aq më shumë ndizet ai. Më në fund gruaja pushon së përpëlituri, nuk e kthen më fytyrën sa në një anë në tjetrën, hapet, dhe ai e depërton, e ajo e mbërthen me të dyja duart, siç ndodh zakonisht në seancat e tyre, kur ajo vjen në qejf.

Kjo skenë e lë burrin pa gjumë. Në mëngjes, me kokën të rëndë, nuk e ka më fort të qartë nëse ka qenë një skenë e përfytyruar, një ëndërr e keqe, apo, “çfarë tmerri (!)” - e ka kryer këtë veprim, ka shkuar te dhoma e gruas, i errur nga dëshira e ngulmët, në të vërtetë e ka përdhunuar atë. Ndihet pothuaj i sigurt, pasi gruaja është çliruar nga orgazmat e saj, është përfshirë nga një dënesë.

“Je i poshtër, - i ka thënë ajo, - sonte unë s’kisha dëshirë, ti më përdhunove. - Je një mashkull i neveritshëm, pervers, ja çfarë je!”

Po ndoshta është ai që ia thotë vetes këto fjalë.

Gjithsesi, kur sinjali i ziles elektronike e lajmëroi se duhej të ngrihej, ai shkoi në banjë i munduar nga një ndjenjë fajësie. Kjo nuk iu shqit as kur u kthye prej andej, zuri të vishej, tashmë gardëroba e tij qe transferuar në këtë dhomë, krejtësisht e huaj për të. Për paradoks, po e bënte të vuante një veprim i parealizuar, i ngjashëm me atë që specialistët e fushës e klasifikojnë “krim i mbetur në tentativë”. Skena e përjetuar prej tij nuk ishte gjë tjetër veçse një përdhunim i mbetur në tentativë.

Bashkëshorten e gjeti në sallon me djalën, tek përpiquej ta gënjente të pinte një gotë qumësht. Priti që, me ta parë, ajo ta pyeste si kishte fjetur mbrëmë. Në këtë rast do t’i tregonte të vërtetën, duke lënë mënjanë skenën e ëndërrt të përdhunimit. Do t’i thoshte se kishte fjetur keq, nata më e keqe e tij në jetën e tyre bashkëshortore, mirëpo gruaja ja ngaqë i biri, zakonisht tepër i bindur, atë mëngjes po tregohej kokëfortë dhe nuk donte ta pinte gotën e qumështit, ja ngaqë as e çoi nëpër mend këtë pyetje, nuk shfaqti ndonjë kureshtje. Për të kishte gdhirë një ditë normale, si gjithë të tjerat, më normale se të tjerat, përderisa kishte shpëtuar nga

gërhimat e tij. Gjithnjë pa i shkuar mendja për keq, burrit iu mblodh një lëmsh në fyt.

Këtu, para se ta vazhdojmë më tej rrugëtimin e të futemi në pyll më thellë, del e nevojshme sërish t'i lëmë burrin dhe gruan, kësaj radhe bashkë me fëmijën, të ngrirë në sallonin e apartamentit, shtatore anonime prej dylli. Bashkë me ta, të lëmë edhe një shenjë të dytë, një tabelë me mbishkrimin: “E nesërmja”. Kronologjikisht, kjo e fundit i paraprin së parës me plot dy vjet.

### 3

*D*eri atë natë, pra, jeta e tij kishte rrjedhur e qetë. Të afërmit, miqtë, kolegët, kushdo që e njihte, e konsideronte njeri me fat. Ai e meritonte këtë fat, vetë Providenca ia sillte punët për së mbari. Një grua të bukur, një apartament të ri në zonën më të gjelbëruar të kryeqytetit, një punë të sigurt për t'u lakmuar, një djalë të urtë, të shëndetshëm. Shtoi këtyre nivelin optimal, gjithashtu të sigurt të jetesës, dy makina, një "Peugeot" ngjyrë blu, të cilën, qysh në fillim, për shkak të largësisë nga zyrat - më shumë ngaqë luante mendsh pas saj - e përdorte bashkëshortja, dhe një "Golf" i blerë lirë, së fundmi, posaçërisht për të. Për një çift të moshës dhe përkatësisë sociale të

tyre, vështirë të përfytyroheshin kushte më të mira.

Nuk mungonin as zërat e një kategorie njerëzish, që mbronin një tezë të ndryshme. Po t'i dëgjoje ata, në këtë mes nuk ndërhynte dhe nuk luante rol ndonjë providencë. Sipas tyre, nëse në këtë rast do të flitej për një providencë fatsjellëse, kjo ishte bashkëshortja e personazhit, vajzë e vetme e një dekani fakulteti, person i njohur publik. Pa ndërhyrjen e këtij të fundit, Gentian Engjëlli do të vazhdonte të ishte sot e kësaj dite një mësues i thjeshtë, specializimin pasuniversitar nëntëmujor në Paris, në fushën e përkthimit, as në ëndërr nuk do ta kishte parë. Këto komente shkonin më tej kur vinte fjala te apartamenti i ri, praktikisht një dhuratë e dyshimtë e “Astra Group” ndaj së shoqes. Kjo bënte ligjin në shtëpinë e tyre, për shembull, një kat më poshtë, në të njëjtin pallat, kishte rregulluar gjyshen dhe gjyshin nga i ati dhe jo, fjala vjen, prindërit e tij.

Të interesuarit nuk i kishte mbërritur në vesh asnjë nga këto komente, megjithëse e përditshmja ia sillte të takohej me ndonjë pëshpëritës apo pëshpëritëse, edhe në rrethin kolegëve, të pinte kafe me ta. Ai as që dyshonte për ekzistencën e komenteve të tilla, po të ndodhte që dikush ta vinte në dijeni, do të ngrinte supet. Sepse, nëse do ta pranonte diskutimin rreth ekzistencës së një



providence kujdestare të tij - ai nuk besonte në providenca, as qiellore, as tokësore - ç'u hynte në punë të tjerëve të humbitnin kohë për t'i vënë asaj një emër, qoftë dhe emrin e bashkëshortes?

Pas tetë vjetësh martesë - një martesë e parakohshme, e diktuar nga rrethanat, e me këtë shpjegohej që dekani i njohur kishte pranuar t'ia jepte të bijën një personi me prejardhje modeste - ai vazhdonte të ndihej i dashuruar pas saj, i bindur edhe për të kundërtën. Nga ana e vet, më e qetë dhe më e ftohtë, ajo e lexonte bashkëshortin si një libër të hapur. Dinte gjithçka rreth tij, të paktën kështu kujtonte.

Gabimisht! Ekzistonte një kapitull i librit, një dashuri e ndaluar, e pandashme me askënd dhe, me gjithë fajësinë që i ngjallte fshehja e tij, nuk ia zbuloi kurrë as asaj. Ishte një tundim, një projekt i ëndërrt. T'u largohej përkthimeve, të shkruante vetë, të bëhej romancier!

Vështirë të thuhet se kur dhe si i lindi Gentian Engjëllit dëshira për të shkruar, të bëhej romancier. I sigurt është një fakt: ai nuk futej në kategorinë e atyre fatlumëve, apo fatkeqëve, që qysh se ngjizen në barkun e nënës, virusin e të shkruarit ua injekton një providencë, për rrjedhojë këtë dhunti ata e shfaqin shumë herët, duke thurur vargje që në moshën katër ose pesë vjeç. Në shkollën

tetëvjeçare, më pas në gjimnaz, ai shkëlqente në çdo lëndë, edhe në ato të shkencave ekzakte, falë një vullneti jo të zakonshëm, por që asnjëherë nuk e ndihmoi të shkëlqente edhe në letërsi. Në gjimnaz, dy mësuese, nëpër duart e të cilave kaloi gjatë katër vjetëve, e shkurajonin me shënime të natyrës “hartim cerebral”, “duhet më shumë fantazi” etj...

Më vonë, në fakultet, ai zuri të provonte veten në përkthim dhe arriti të botonte në shtojcën javore letrare të një gazete të përditshme në fillim një cikël vjershash nga Jacques Prevert, më pas tregime të shkurtra nga Maupassant, një tregim relativisht të gjatë nga Le Clezio, e ndonjë gjë tjetër. Njëra nga ish-mësueset paskej lexuar diçka, ndodhi ta takonte në rrugë, e përgëzoi sinqerisht, kështu i tha: “Të përgëzoj sinqerisht me gjithë zemër”, duke harruar se që ai të mos dilte në përfundim të maturës me medalje ari - ambicia e tij e parë e fshehur, e perealizuar - një ndihmesë jo të vogël kishte dhënë edhe ajo vetë.

Ai e falënderoi me mirësjellje, duke u ngutur të ndahej prej saj. Kjo mësuese sillte automatikisht në mendjen e tij fjalën “debile”. Ndihej keq, këtë nofkë nuk e nxirrte nga xhepi i vet, dikush tjetër ia pëshpëriste në vesh sa herë përballëj me të. Ky ishte një shkrimtar i dëgjuar, e njihte si emër prej librave, si fytyrë nga televizori, e quanin... Gentian K. Engjëlli!

Rastësi lumturuese! Ai përkëdhelej në sedër, të thuash se përfitonte diçka nga fama e shkrimtarit, edhe pse ndonjë bashkënxënës e shpotiste duke i thirrur: “Ku je, o Gentian Engjëlli pa K.?!”

Vështirë të thuhet gjithashtu nëse dëshira e tij për t’u bërë romancier, u ndikua nga kjo rastësi, domethënë që mbante emrin e një shkrimtari, i cili, për t’u dalluar nga Gentian Engjëjt e mundshëm në qarkullim, të djeshëm, të sotëm apo të nesërm, përdorte shkronjën K. Ende nxënës, ai e pyeti një herë të atin nëse shkrimtari ishte i afërm i tyre, por u hidhërua kur mësoi se midis tyre nuk ekzistonte asnjë lidhje fisnore, qoftë dhe e largët. Në këto kushte, ai vendosi ta krijonte lidhjen vetë, zuri të lexonte çdo libër të adashit të shquar.

Canga ca kjo lidhje fitoi një natyrë të veçantë. Sa herë mërzhitej nga shënimet zhgënjyese me laps të kuq, ai i drejtohej adashit, e pyeste pa ndonjë shpresë se do të mund të merrte përgjigje, nëse vërtet hartimet e tij nuk vlenin. Për një kohë të gjatë ky i fundit nuk iu përgjigj. E braktisi heshtjen një ditë, kur mësuesja po komentonte në klasë një nga romanet e tij.

“Mos ia vër veshin, - i pëshpëriti, - është debile. - E dëgjon ç’marrëzira këput për librin tim?”

Vërtetësinë e kësaj pëshpërimë e vuri në dyshim i pari ai vetë, jo aq për fjalën “debile”,

e papritur nga goja e një njeriu të respektuar. Në ato çaste, me sytë e ngulur te buzët e mësueses, ai po mendonte pak a shumë të njëjtën gjë. Ndjeu t'i ngrihej së brendshmi një afsh, një kënaqësi e paprovuar dhe, në përputhje me këtë, krijoi një botë virtuale komunikimi me adashin e tij. Prej këndeje, edhe këshilla e parë: që të mund të bëhej romancier, fillimisht do t'i duhej të kryente ca punë prej çiraku. Si ata artistët, piktorë e skulptorë të Mesjetës, që u bënë të famshëm duke i mësuar të fshehtat e zanatit në punishte mjeshtresh të mëdhenj. Këtë këshillë ai e zbërtheu në të vetmen mënyrë, që përputhej me ambicien e tij të fshehur. Për të shkuar drejt mjeshtërisë së romancierit, fillimisht duhej të bëhej çirak, të përkthente tekste mjeshtresh të mëdhenj.

Me prirjen e lindur ndaj gjuhëve të huaja, në mbarim të maturës, të cilën e kapërceu me pengun e madh e të pangushëllueshëm që s'mundi të dilte me medalje ari, ai ndodhej në nivelin më të përparuar të një gjimnazisti në gjuhët frëngjisht dhe anglisht, të parën si gjuhë të detyrueshme në programin shkollor, të dytën duke marrë mësimë private në shtëpinë e një zonje në prag të pensionit. Për të kompensuar rrogën e ulët prej arsimitareje në ato kohë plot pasiguri të gjysmës së parë të viteve '90, ajo u jepte mësimë dy herë në javë në një nga dhomat e apartamentit të saj atij dhe dy nxënësve të tjerë.

Tani, nëse i përmbahemi mendimit të pjesës më të madhe të atyre që e njihnin se ai ishte njeri me fat, e meritonte këtë fat dhe vetë Providenca ia sillte punët për së mbari, mund të pohohet se ajo u orvat qysh herët t'i fliste edhe në gjuhën gjermane. Nga viti i tretë i gjimnazit, atij i ra në dorë një tekst për mësimin autodidakt - kështu shënohej në kapakun e librit - të gjuhës gjermane. Pa e vlerësuar fjalën e urtë sipas së cilës nën sqetull nuk mund të mbash më shumë se një kungull, përderisa deri atëherë ia kishte dalë të mësonte njëherazi frëngjisht dhe anglisht, ai deshi të mësonte edhe gjermanisht. Dështoi zemërthyer, i vendosur t'i rikthehej gjermanishtes në një çast më të përshtatshëm, kur të krijoheshin kushtet. Këto kushte nuk u krijuan kurrë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por u krijuan në një kontekst të ndryshëm, dhe njohuritë elementare të gjermanishtes e ndihmuan për diçka pa lidhje me mësimin e gjuhës. Të kalonte përvojën e parë dashurore.

Më vonë këtë përvojë ai e përfytyronte në trajtën e një përralle dimri. Ato ditë sapo kishte lexuar në shqip poemën "Gjermania, përrallë dimri" të Hajnes dhe i mrekulluar ndihej i zhvendosur në një botë të ëndërrt. Por ndoshta më shumë ngaqë ajo përvojë nisi në dimër. Ishte në vitin e dytë të fakultetit dhe kalendari qe mbërthyer në shifrën 1998.

Duket, për këdo ekziston një ditë përcaktuese, kur ngrihet një sipar. Në rastin e tij, dita e ngritjes së siparit përkoi me mesin e dhjetorit të atij viti. Në të vërtetë qe një ditë e zymtë, e ftohtë, e mërzitshme, nuk paralajmëronte asgjë, aq më pak ngritjen e ndonjë sipari. Ajo gdhiu me një rrebesh të madh, rrugët u përmbytën, në fakultet mbërriti me vonesë, leksionin e parë e humbi. Leksionin e dytë e humbi për një arsye tjetër, pedagogu i radhës kishte pësuar një aksident me makinë, u tha se e kishin çuar në spital. Shumica e studentëve të grupit të tij e panë me vend të largoheshin fare, të mos merrnin pjesë në leksionin pasardhës. Ai qëndroi, s'kishte arsye të largohej, s'kishte ku të shkonte përveçse në shtëpi. Ndërsa në shtëpi nuk e priste asgjë, madje edhe prindërit vështirë të ishin kthyer.

Jetonte me prindërit - sigurisht, do të vërente i habitur, me kë tjetër - të dy në prag të pensionit, e ëma infermiere në një ambulancë lagjeje, i ati mësues biologjie, që për të plotësuar normën jepte mësim në dy shkolla të ndryshme. Kishte edhe dy motra, më të rritura në moshë, të martuara e me fëmijë, ikur prej kohësh nga Shqipëria me rrëmujat e fillimit të viteve '90, të vendosura përkatësisht në Itali dhe Gjermani. Qysh atëherë prindërit e tij rronin me frikën në zemër se mos, në rrëmujat të pritshme ikte edhe ai, vendosej

te ndonjëra nga motrat, apo gjetiu. Atij i qe dashur t'ua përsëriste shpesh, as i shkonte nëpër mend të ikte, prandaj të flinin të qetë, e ata nuk flinin të qetë, dhe bënin çmos t'i plotësonin çdo tekë apo dëshirë. Tekat nuk ia lejonte vetes, dëshirat i frenonte.

Zuri vend në hyrje të fakultetit, ku nja dhjetë-pesëmbëdhjetë vetë qëndronin duke vështruar shiun, sheshin e përmbytur para godinës, të pavendosur se ç'duhej të bënë, të iknin apo të rrinin. Herë-herë dikush vinte me vrap në drejtim të hyrjes, ose anasjelltas, dikush largohej në drejtim të rrugës, por me gjithë largimet apo mbërritjet, grumbulli soditës mbetej i pandryshuar në numër, dhjetë-pesëmbëdhjetë vetë.

Pati një mendjeshkrepje, të ndiqte shembullin e atyre që largoheshin, të derdhej nëpër shi.

“Nuk jam kallam sheqeri që të tretem, - mendoj, - të mbërrij deri te stacioni i autobusit, prej andej disa stacione dhe në shtëpi...”

Nëse prindërit mund të mos ishin kthyer, ata me siguri nuk duhej të ishin kthyer, të mbyllej në dhomën e tij, të kryente ndonjë punë. Për shembull, redaktori i shtojcës së përjavshme kulturore të gazetës “Epoka”, i cili i botonte ndonjë përkthim, admirues i flaktë i Dino Buzzat-it, e kishte porositur t'i përkthente ndonjë tregim. Atij vërtet i ndodhej një vëllim me tregime të Dino Buzzat-it, në

frëngjisht ama, dhe i kishte shpjeguar se nuk ishte në gjendje të përkthente nga italishtja, ndërsa botimi i një përkthimi të këtij autori nga frëngjishtja, do të ishte jo i përshtatshëm. Tjetri i kishte thënë të mos merakosej fort për këtë, tekefundit s'po e shënonin nga ç'gjuhë që përkthyer, askush nuk do të merrte vesh gjë!

E kotë të lodhej ta bindte për të kundërtën, por atë paradite nuk e mori rrugën e shtëpisë jo sepse nuk donte të ulej të përkthente Buzzat-in nga frëngjishtja. Ai thjesht nuk kishte dëshirë të përkthente, pavarësisht nga ç'gjuhë, s'kishte dëshirë të lexonte, pavarësisht çfarë libri, nuk kishte dëshirë të bënte asgjë, madje as të largohej, as të rrinte në fakultet.

I ndodhte jo rrallë të përfshihej nga limonti të tilla, veçanërisht kur lexonte ndonjë libër mjeshtrash. Çarmatosej, e humbte besimin në vetvete, ideja e fshehur për t'u bërë romancier largohej në një galaktikë të paarritshme, për ca kohë nuk i jepej të bënte asgjë. Prindërit kishin parasysh këto gjendje kur rrinin me zemër të ngrirë se mos ishte mërzitur prej tyre dhe një ditë i mbushej mendja të ikte. Ndërsa limontia e tij s'kishte kurrfarë lidhjeje me ta, dhe ndihej i paaftë t'ua mbushte mendjen, t'i qetësonte. Kjo i krijonte një stres të kotë, të ngjashëm me stresin që i përftohej nga paaftësia për të bindur redaktorin e shtojcës



së përjavshme kulturore të gazetës “Epoka”, dashamir ndaj tij, se do të ishte i pafalshëm për të, aq më pak në nderin e gazetës - veten e konsideronte një çirak fillestar - botimi i një tregimi të Buzzat-it të përkthyer nga frëngjishtja.

Hoqi dorë nga ideja për t’u derdhur nëpër shi dhe meqë nuk mund të rrinte më as midis grumbullit soditës, duke shpresuar të zbavitej sadopak me vrapin e individëve që iknin apo vinin përmes rrebeshit, këmbët e çuan në katin e dytë, në krahun e gjuhëve të huaja. Dyert e klasave qenë të mbyllura, përveç njërës, në fund të korridorit, prej nga mbërrinin zëra. Shkoi drejt fundit të korridorit. Sa më shumë afrohej, aq më të qartë bëheshin zërat dhe pati përshtypjen sikur, kush e di për ç’arsye, mësimi po zhvillohej me derën e lënë hapur.

Atje nuk po bëhej mësim, sytë nuk i zunë asnjë pedagog apo pedagoge. Klasa që e mbushur nga një numër studentësh e studentesh, këto të fundit në shumicë dërmuese, ca të ulur nëpër banka e ca në këmbë.

Megjithëse automatikisht, zuri vend në një bankë, do të ishte larguar edhe prej andej. Atje flisnin me zë të lartë, me humor dukshëm më të ngritur se humori i tij, e kjo i krijoi një pakënaqësi pa adresë, i pazoti të merrte pjesë qoftë edhe si dëgjues në bisedën e tyre. Derisa kuptoi përse gati po grindeshin. Përpiqeshin

të vendosnin se kush nga gjuhët tingëllonte më bukur, anglishtja, frëngjishtja, italishtja apo spanjishtja, diskutonin me zjarr pa u marrë vesh, kushdo në mbrojtje të portës së vet, domethënë të gjuhës që studionte. Pa mundur të gjenin një emërues të përbashkët për vendosjen e kurorës, puqeshin në një pikë. Më pak e bukura tingëllonte gjermanishtja!

“Për besë, - tha me vete, - ç’bëj unë këtu, duke dëgjuar idiotësira?”

Atëherë, nga ana e kundërt e klasës, i mbërriti një zë vajze.

- Këto që thoni ju janë idiotësira, nuk e kuptoni që po flisni idiotësira?

Ai ktheu kokën andej nga erdhi zëri. Një telepati, ndryshe si shpjegohej që vajza kishte formuluar njëkohësisht pothuaj të njëjtin mendim? Midis qetësisë që ra, ai vërejti se vajza ishte ndër të paktat fytyra të panjohura për të në atë mjedis. Por qetësia sundoi vetëm për një çast. Zërat kundër iu hodhën në kor dhe ajo më kot përpiquej t’u kundërvihet, në mbrojtje të dinjitetit të gjermanishtes.

Në qoshen ku po rrinte, duke vështruar disa metra më tej fytyrën e saj, ai pati përshtypjen e fortë sikur, megjithëse e panjohur, ajo i kujtonte diçka. Kishte ca sy të mëdhenj, të zinj dhe, tek i shihte, më në fund i tingëlloi në veshë një frazë e harruar: “Schau mir in die Augen, Kleines!”.

I erdhi të ngrihej, të shkonte pranë vajzës e t’i thoshte: “Schau mir in die Augen,

Kleines!”, dhe t’i tregonte si qëndronte puna. Domethënë, gjatë viteve të gjimnazit ai qe marrë pak me gjuhën gjermane dhe në faqen e një teksti me të cilin ishte rropatur disa kohë dëshpërimisht, në një fotografi, riprodhohej një skenë nga filmi “Kazablanka”, ku protagonistin i thotë partneres: “Schau mir in die Augen, Kleines!”.

I kishte lënë mbresa të pashlyeshme kjo batutë, me një tingëllim të magjishëm, tërë muzikë. Qysh atëherë, ndër vite, ai priste të haste një palë sy që t’i ngjallnin dëshirën t’u pëshpëriste këto fjalë. Siç mund të merret me mend, sy të tillë kishte hasur shpesh, por pa guxuar t’ua recitonte formulën, për arsye nga më të ndryshmet. Kryesorja, asnjëra nga vajzat s’dinte gjermanisht, dhe ai dëshironte ta recitonte formulën vetëm në origjinal, ndryshe, e përkthyer, ajo do ta humbiste magjinë.

Truri i tij u vu në lëvizje. Ishte në moshën kur njeriu bie lehtë pre e asaj që francezët e quajnë “coup de foudre”, por aty për aty ai nuk mendonte në frëngjisht. Aty për aty sundohej nga një dëshirë e vetme, t’i recitonte vajzës së panjohur me sy të mëdhenj, të zinj, një refren gati të harruar, i bindur se ky ishte çasti i shumëpritur prej tij ndër vite. Nuk e zgjati më, u ngrit, shkoi pranë tabelës së zezë, mori një shkumës dhe, duke u kujdesur t’i bënte shkronjat të lexueshme, shkroi: *Schau mir in die Augen, Kleines!*

- A mund të më thotë ndokush ç'kuptim kanë këto fjalë? - iu drejtua klasës.

Pyetja i zuri në befasi të gjithë, s'po merrnin vesh përse ai tip kishte dalë pranë tabelës, ç'kërkonte prej tyre, u stepën dhe e mbërthyen me vështrim. Po ashtu edhe vajza me sy të mëdhenj, të zinj.

- Këto fjalë, - shpjegoi duke përfutur nga stepja e tyre, - siç mund ta vini re, janë në gjermanisht. Në shqip përkthehen pak a shumë kështu: Shikomë në sy, vogëlushe!

Ai u përqendrua te sytë e mëdhenj, të zinj.

- Meqë ju po grindeni se cila gjuhë tingëllon më bukur, - vazhdoi, gjithnjë i përqendruar tek e panjohura, - ju ftoj të formuloni në gjuhët që studioni këtë shprehje, dhe ta krahasoni me variantin gjermanisht. Në frëngjisht, një përkthim të diskutueshëm po e formuloj vetë: *Regarde moi dans les yeux, ma petite!* Të mos dalë kush të vërë në dyshim tingëllimin e gjuhës frënge, por shprehja që ju propozova në gjermanisht, me valëzimin e tingëllores "a", sjell për veshin një muzikë të vërtetë.

Në stepjen e përkohshme të klasës, ai përjetoi një çast ngadhënjimi, vajza i tundi kokën me një buzëqeshje të lehtë. Mirëpo, pikërisht në atë çast ngadhënjimi, i mbërritën dy shuplaka, fjalët "Posi ore, na mbushe mendjen!", të shqiptuara nga një zë femëror, dhe një vërejtje, kësaj radhe nga një zë mashkullor, i cili i kërkoi të mos u mbante

leksione; ata nuk gjendeshin aty për të dëgjuar leksionet e tij! Te zëri femëror kapi qesëndi, te mashkullori, ligësi. Njëherazi i ndodhi diçka e çuditshme. Ai as e kuptoi, as e shpjegoi dot, më pas, për një kohë të gjatë, u pri të besonte se kishte qenë një nga ato dukuritë e quajtura paranormale. Pa pritur e pa kujtuar vajzën e panjohur e humbi nga sytë.

Ç'është e vërteta, pas zërit qesëndisës femëror dhe ligësisë së mashkullit, në klasë u ngrit një zhurmë, ai u shpërqendrua, deshi të shihte në sy ngacmuesit e tij, dhe i pa, dhe u trondit. Sidomos nga pamja inatçore e djalit, të thuash se e kishte fyer rëndë, kur edhe atë individ po e shihte për herë të parë.

Nuk ia vlente të merrej me ta. U shkëput prej tyre, për t'u rikthyer te sytë e mëdhenj, të zinj, por ata ishin zhdukur. Gati misteriozisht. Meqë e panjohura s'mund të kishte fluturuar nga dritarja, mbetej të ndodhej në korridor.

Korridori, në tërë gjatësinë e tij, i kredhur në gjysmë errësirë për shkak se të gjitha dyert, në të dyja krahët, meqë bëhej mësim, vazhdonin të qëndronin të mbyllura, ishte bosh. Ai e hodhi poshtë gjasën që ndërkaq ajo të mund të qe futur në ndonjë klasë tjetër, logjika nuk e pranonte. Kushedi për ç'arsye duhej të ishte larguar me ngut, dhe nëse donte ta shihte prapë, duhej t'u jepte këmbëve. Ai zuri gati të vraponte, mbërriti në fund të korridorit, pranë shkallëve, i kapërceu edhe ato me një frymë,

por vajzën e panjohur nuk e pa gjëkund. As në sheshpushimin pranë hyrjes kryesore, ku vazhdonte të rrinte në pritje, duke vështruar shiun dhe tipat që largoheshin apo vinin me vrap përmes shiut, i njëjti grumbull në numër të pandryshueshëm soditësish, prej dhjetë-pesëmbëdhjetë vetash.

Më kot u end poshtë e lart nëpër korridoret e fakultetit. Më kot kontrolloi nëpër kioskat aty rrotull. Më kot qëndroi nja dy-tri ditë me radhë në hyrje të fakultetit, përpara fillimit të leksioneve duke përgjuar studentet. Më kot qëndroi aty edhe pas mbarimit të orëve të fundit, duke përgjuar largimin e tyre. Vajzën e panjohur nuk e pa gjëkund, sikur e kishte përpirë dheu. I duhej të pranonte të papranueshmen, domethënë gjithçka kishte qenë një prodhim i trurit të tij.

Ai do ta pranonte pa vështirësi këtë të papranueshme po të mos ekzistonte një e vërtetë kokëfortë: fytyra e një djali. Nuk u interesua të mësonte kush ishte ai djalë, çfarë gjuhe studionte, në cilin vit, banonte në kryeqytet apo vinte nga rrethet. Sa herë përballej me të në mjediset e fakultetit i shmangej, me pamjen gjithnjë të ngrysur tjetri i ngjallte një ndjesi papastërtie. Dhe, me kohë, një përshtypje pothuaj të sigurt. Ai tip, ose “inatçori”, siç zuri ta quante, kushedi përse e urrente!

Me mendje më të ftohtë, urrejtja që lexonte në sytë e tij - ca sy të shpëlarë, në një fytyrë të

zbehtë, me tipare të hequra, shenjë dalluese e njerëzve të kequshqyer apo të keqtrajtuar në fëmijëri - do t'i kishte shërbyer si subjekt refleksionesh. Dhe ndonjë ditë, kur të kryqëzoheshin në mjediset e fakultetit apo gjetiu, ta ndalonte, t'i tregonte kush ishte, të kërkonte të njëjtën gjë prej tij dhe ta pyeste, mbase edhe të diskutonin. Nga ç'motive mund të nisej një individ të përbuzte apo urrente dikë, pa e njohur dhe pa shkak?

S'varej prej tij. Qysh se vajza e panjohur i humbi nga sytë në një çast shpërqendrimi, ai humbi edhe qetësinë. Përballjet me "inatçorin" zunë ta acaronin, i dukej sikur nuk ishin më të rastësishme, derisa e përshkoi një dyshim. Mos vallë ekzistonte një lidhje midis atyre të dyve?

Ajo iu shfaq sërish nja tre muaj më vonë. E takoi një të diel marsi dhe, duke qenë e diel, kuptohet, ai nuk doli nga shtëpia për të shkuar në fakultet. Ai thjesht u gdhi keq.

Nuk kishte lexuar ndonjë libër mjeshtri ato ditë që ta përlligjte humorin e tij të rënë me efektin e artit të madh, prej ca kohësh nuk lexonte. Pas kërkesave të përsëritura të redaktorit të shtojcës kulturore të gazetës "Epoka", ato ditë ai qe thyer, kishte marrë përsipër të përkthente nga gjuha frënge një tregim të Dino Buzzat-it. Por as kjo nuk ishte një arsye e plogështisë së atij mëngjesi.

E diela kishte gdhirë e zymtë, me shi, rrugët qenë përmbytur, duke ua bërë jetën skëterrë të gjithëve. Në këtë mes ai nuk vuri re ndonjë gjë të veçantë që t'i sillte ndër mend diçka, të përligjte daljen e tij në kërkim të diçkaje, e të mund të thuhet, për shembull, se në atë mëngjes të vrenjtur, shumë të ngjashëm me një mëngjes të tre muajve të shkuar, ai i mori rrugët i nxitur nga kushedi se çfarë telepatie.

E vërteta qëndronte pak më ndryshe. Gjatë natës, për shkak të pozicionit jo të mirë të kokës mbi jastëk ose të trupit, kishte bërë një gjumë të trazuar. Në raste të tilla ai përjetonte të njëjtin makth. I bëhej sikur rreth tij s'kishte asgjë, nuk ekzistonin as prindërit, as të motrat diku larg, as të njohurit, as të afërmit, asgjë prej gjëje. Ishte i vetëm në një botë hermetike, një grimcë e papërfillshme, në një komunitet planetar të përbindshëm individësh, plot me shkrimtarë, përkthyes, çirakë e të tjerë, një pafundësi shkrimtarësh, përkthyesish, çirakësh e të tjerë, të gjallë apo të vdekur. Ai përpiquej të përcaktonte ku ndodhej, te të gjallët apo të vdekurit, e kjo e mundonte, i zinte frymën dhe në mëngjes, kur hapte sytë, mezi çlirohej nga makthi.

Një i njohur i tij, djalë lagjeje, tashmë student në vitin e fundit për mjekësi, kur para ca kohësh ia kishte shpjeguar këtë lloj makthi, i kishte thënë të mos merakosej, mjafton të blinte një dyshek të përshtatshëm,



sidomos një jastëk të përshtatshëm, dhe të mos e rëndonte stomakun në darkë. Këtyre këshillave u kishte shtuar duke qeshur edhe një të fundit. Nëse ai ende nuk kishte fjetur me ndonjë vajzë, duhej ta zgjidhte këtë punë. Atëherë, edhe gjumin e natës do ta bënte më të qetë. Ndër këto këshilla, ai kishte plotësuar dy të parat, të tretën pjesërisht, të katërtën virtualisht!

Ai nuk doli nga shtëpia me synim jetësimin e këshillës së katërt. Poshtë, te hyrja e shkallës, me çadrën në dorë, duke vështruar makinat në rrugën gjithë gropa para pallatit, një copë herë mbeti i përhumbur, pa e vendosur ku mund të shkonte. Një mendje i tha të shkonte nga Biblioteka Kombëtare. Një mendje tjetër, te Lidhja e Shkrimtarëve.

Në bibliotekë ai shkonte shpesh për të rrëmuar nëpër skedarë, hidhte ndonjë sy edhe te salla e leximit. Te Lidhja e Shkrimtarëve shkonte rrallë, me një synim të vetëm: të shihte, mundësisht të takonte, adashin e tij. Nuk i rastisi kurrë ta shihte. Sipas redaktorit të shtojcës kulturore të gazetës “Epoka”, Lidhja e Shkrimtarëve nuk ishte gjë tjetër veçse një kalë i ngordhur, atje mund të gjeje çfarë të doje, veç jo shkrimtarë.

“Le që çfarë shkrimtarësh ka Shqipëria, - kishte shtuar ai, - hiq nja dy-tri kokrra, të tjerët nuk vlejnë një grosh, grafomanë të fryrë me veten.”

Do të kishte dashur ta pyeste ku e fuste ai adashin e tij, te kategoria e dy-tri kokrrave, apo te ajo e grafomanëve të fryrë me veten. Duke ia njohur mendimet, druajti se mos e fuste pikërisht te kjo e fundit. Ai nuk mund ta pranonte këtë, do t'i kundërvihej, për rrjedhojë marrëdhënia e tyre mund të lëkundej, mund të prishej fare. Ai nuk donte ta prishte këtë marrëdhënie, megjithatë, kur ndonjëherë shkonte nga Klubi i Lidhjes, i jepte të drejtë. Tipat që shihte atje, në grupe nga tre e nga katër nëpër sallë, duke pirë, nuk ia mbushnin mendjen, tepër të zakonshëm për të qenë shkrimtarë. Me këtë e shpjegonte që adashin e tij nuk e shihte atje, duket edhe për të Lidhja e Shkrimtarëve ishte një kalë i ngordhur.

E braktisi hyrjen e shkallës dhe zuri të ecte nëpër shi. Nja pesëmbëdhjetë minuta më vonë u gjend në qendër të kryeqytetit, mbi trotuarin nga krahu i Bankës, pothuaj njëlloj larg Bibliotekës Kombëtare dhe Lidhjes së Shkrimtarëve. Nuk shkoi as te njëra, as te tjetra. Anashkaloi qytezën e vogël të kioskave në lulishten midis Bankës dhe Teatrit të Kukullave, për të dalë në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”. Disa minuta më vonë u gjend në kufi të qytezës së madhe të kioskave, të cilat në atë kohë vazhdonin të popullonin të gjithë hapësirën e parkut “Rinia”. Vetja iu duk si një robot i komanduar. Nuk e pati në dorë të mos i bindej edhe më tej të njëjtës

komandë, së cilës i qe bindur pa vetëdije me atë sorollatje nëpër shi. U fut në rrugicat e qytezës, derisa mbërriti para njërës prej tyre. Më e larta, plot tri kate.

Vajza e panjohur iu shfaq atje, në lokalin e katit të dytë. Për njëfarë kohe ai nuk e vuri re. Ajo po rrinte në një tryezë në anën e kundërt të lokalit, pranë dritares, e fshehur pas trungut të një peme që dilte prej katit të parë, përshkonte tavanin e katit të dytë, për t'u ngjitur në katin e tretë e përtej tij.

Gjatë verës së shkuar ai kishte ardhur këtu me bashkëshortin e motrës së Italisë, si dhe dy italianë, miq të tij. Këta ishin habitur me trungun e pemës mespërmes ngrehinës, dhe i kunati qe mburrur, po ndoshta qe tallur. "Siç e shihni, - u kishte thënë miqve, - kemi edhe ne ca gjëra origjinale, vështirë të përfytyrueshme." Tek vështronte trungun, ai po rrekej të përcaktonte nëse i kunati qe mburrur apo qe tallur, dhe mbeti pa frymë. Iu duk sikur në një pjesëz të sekondës pa atë, vajzën e panjohur me sy të mëdhenj, të zinj. Por ky qe vetëm një çast, e panjohura u zhduk, humbi përsëri pas trungut.

Nga vendi ku ishte, ai dallonte qartë mbi tryezën tutje një nga ata filxhanët e mëdhenj, të bardhë, me të cilët shërbehet kapuçino, dhe një dorë që herë shtrihej drejt filxhanit, e merrte, humbiste bashkë me të pas trungut, pastaj shfaqej prapë, e kthente sendin në

vendin e tij, dhe më tej kësaj dore i shtohej edhe tjetra, dhe të dyja luanin me filxhanin. Pa e duruar gjatë këtë lojë, ai lëvizi, zuri vend në një tryezë tjetër, prej nga mund ta shihte kush fshihej pas trungut të pemës.

Ishte ajo, vajza e panjohur, me sy të mëdhenj, të zinj. Vetëm. Një copë herë as ajo nuk e pa, vazhdoi të luante me filxhanin, derisa ngriti kokën. Në fytyrën e saj u end një buzëqeshje dhe ai u kthye prapa, për të parë se kujt i drejtohej. Askujt! Dhe askush përveç tij nuk mund të lexonte një frazë me tingëllim të magjishëm, që e formuluan në largësi ja sytë, ja buzët e saj: *Schau mir in die Augen, Kleines!*

Shkoi tek ajo. Që nga ai çast nisi për të enigma më e madhe e jetës.

Tjetra e priti në mënyrën më të çuditshme, me një ankesë. Ai po fitonte një zakon të keq, prej disa kohësh vonohej në takimet e tyre, tani ajo po e priste aty prej një ore dhe kishte pirë dy kapuçino radhazi!

Ai ngriu. Në fillim e mori këtë si një shaka të saj, ndoshta me synim që ta bënte sa më të lehtë takimin e tyre të papritur dhe e gjykoi me vend t'i përgjigjej po me një shaka, pak a shumë të ngjashme. Edhe unë kam kohë që të pres, deshi t'i thoshte, plot një shekull. Por kjo iu duk tmerrësisht artificiale, e lexuar diku.

Tekefundit, nuk po e priste prej një shekulli, për të qenë i saktë duhej të përcaktonte kohën prej vetëm tre muajsh, qysh se ajo qe zhdukur, i kishte humbur nga sytë në mënyrë të mistershme, në një ditë të zymtë me shi, si e sotmja. Dhe u ngatërrua me veten. Ai e priste t'i shfaqej shumë më parë. Lidhej me diçka të largët, një tekst për mësimin e gjuhës gjermane, e qysh atëherë ëndërronte një vajzë. Tani vajza e ëndërrt ndodhej me mish e me kocka përpara tij. Duke u përpjekur të fshihte një pështjellim, u përgjigj:

- Më vjen keq që të kam lënë të presësh, mezi mbërrita, gjithë ky rrebesh!

Nuk e besoi që kishte arritur ta formulonte këtë përgjigje. Ata nuk njiheshin, s'kishin lënë asnjë takim më parë ku, për më tepër, siç pretendonte ajo aq seriozisht, ai të qe vonuar. Kjo qe një arsye e fortë që ai të vinte në dyshim gjithçka. Ndoshta, gjykoi, gjithçka që i shfaqej në ato çaste ishte një nga ato vithisjet në gjumë, kur nuk e ndante të vërtetën nga e pavërteta, dhe përjetonte gjendje nga më të çuditshmet.

Si të donte t'ia hidhte poshtë këtë mendim, vajza vijoi me të vetën:

- Ti e dije se sot do të takoja Lolën, - i tha, - ia di dhe hallin, megjithatë u vonove.

Pastaj, e mbërtheu me sytë e mëdhenj të zinj dhe i dha goditjen trulllosëse.

- Edhe dy minuta po të vonoheshe, nuk do të më gjeje këtu... Tani, që të mos rrish vetëm,

eja me mua, por nuk ta këshilloj, s'do të më pëlqente të ishe i pranishëm.

Ai pati një ngasje t'i pohonte të kundërtën, pra do t'i pëlqente shumë të shkonte me të në takimin me të quajturën Lola. Mirëpo tjetra e kishte vendosur, do të shkonte vetëm. U ngrit, mori çantën, e vuri në sup, mori edhe çadrën e mbështetur pas trungut të pemës, i tha se kapuçinot i kishte paguar, dhe i zgjati faqen. Pa kuptuar ndonjë gjë nga e gjithë kjo, ai u fut në lojë. E puthi në të dyja faqet, duke u përpjekur të mos e kalonte masën, domethënë ta puthte në buzë, siç dëshiroi. Çastin e fundit iu dha ta pyeste se kur do të shiheshin prapë. Ajo iu përgjigj se, si zakonisht, do të shiheshin të nesërmen, në fakultet. Dhe iku, u zhduk e përrpirë nga shkallët.

Pas zhdukjes së saj, atij iu desh të mblidhte veten. Po të mos e bënte këtë dhe të binte pre e ca dyshimeve, rrezik të luante mendsh. Filxhani bosh i kapuçinos mbi tryezë dhe një aromë parfumi që ajo ia kishte kaluar bashkë me të puthurën, ishin të mjaftueshme për ta qetësuar, t'u besonte shqisave. Por logjika e këshilloi të kërkonte një vërtetim të saktësisë së tyre, dhe rasti iu dha shpejt. Me t'u zhdukur ajo, në tryezën e tij mbërriti kamerieri, e pyeti ç'dëshironte. Nga ana e vet, ai e pyeti kamerierin nëse mikësja e tij e sapolarguar - e sapozhdukur, qe fjala që i përshkoi trurin - ishte shlyer me të. Tjetri iu përgjigj:

- Sigurisht, zonjusha, kliente e rregullt e lokalit,u shlye...Dhe mbeti në këmbë në pritje të porosisë së tij, derisa ai u kujtua.

- Një kapuçino edhe për mua, - i tha. Kur kamerieri ia solli kapuçinion, ai u ndie i aftë të arsyetonte.

Sipas gjasave, prej disa kohësh ai duhej të kishte një mikeshë, apo një të dashur. Qysh kur? Vështirë ta thoshte. E rëndësishme ishte të mësohej me këtë ide, domethënë që prej disa kohësh ai kishte një mikeshë apo të dashur dhe sapo ishte ndarë prej saj pas një takimi të rastësishëm. Nëse takimi i tyre nuk kishte qenë i tillë, përkundrazi, siç i qe ankuar ajo, po e priste aty prej një ore, dilnin një varg pikëpyetjesh. Më elementarja: kush ishte ajo vajzë së cilës nuk i dinte as emrin?

Ai e hodhi vështrimin nga banaku. Sipas kamerierit, ajo qenkej një kliente e rregullt pra, në mos ai, banakierja mund t'ia dinte emrin. Mirëpo në këtë rast i duhej të pranonte edhe një gjasë tjetër. Shpesh apo rrallë, bashkë me të këtu duhej të kishte ardhur edhe ai, e pamundur që kamerieri apo banakierja të mos e kishin vënë re në shoqërinë e saj!

E pa veten të zënë në kurth, arsyetime të tilla nuk e çonin gjëkund. Në vend që të merrej me hamendje në erë, përballë faktit të kryer - ekzistencën e vajzës as që donte ta vinte në dyshim - më mirë të përballlej me një hollësi

praktike. Cila ishte natyra e marrëdhënies së tyre?

Nga biseda me të mund të nxirrte një përfundim. Bëhej fjalë për një marrëdhënie të afërt, mbase shumë të afërt, nuk përjashtohej varianti që ata të mos ishin thjesht miq, të kishin shkuar më tej. Këtë ia përktheu vetes kështu:

“Me gjasë, duhet të kem një marrëdhënie dashurore. Kjo është dhe përvoja ime e parë dashurore. Sado e çuditshme të duket, unë ndihem i dashuruar me një vajzë së cilës nuk i di as emrin. Asgjë e jashtëzakonshme! Di se ajo ka ca sy të mëdhenj të zinj, është pak e mërzitur prej meje që e paskam bërë zakon ta lë të presë, dhe tani ka shkuar të takojë një mikeshë, të quajtur Lola. As që e kam idenë se kush është Lola. Diçka duhet t’i ketë ndodhur, dreqi e merr vesh se çfarë, por unë s’di gjë, megjithëse del se duhet të di, e kësaj i thonë ‘lesh arapi’, e duhet të pres deri nesër për ta sqaruar!”.

E nesërmja gdhiu një ditë e ftohtë, e kthjellët. I vendosur të vinte pikat mbi “i”, ai u ngrit herët, por pa asgjë të qartë në kokë. Duke e marrë të mirëqenë pohimin e saj, sipas të cilit ata shiheshin në fakultet, ai nuk e dinte se ku dhe kur shiheshin. Shkonte ai tek ajo, apo vinte ajo tek ai. Dhe, nëse logjika e donte të shkonte ai në kërkim të saj, ku duhej



ta kërkonte? Përveçse nuk i dinte emrin, ai nuk dinte as se në ç'vit të gjuhës gjermane ishte, po të pranonte se ajo ndiqte studimet për gjermanisht.

I mbetej vetëm një zgjidhje: t'i zinte pritë në hyrje të fakultetit, njëlloj si tre muaj të shkuar kur ajo i kishte humbur nga sytë. Kështu veptoi, gjysmë ore para se të nisnin leksionet, ai zuri vend të hyrja kryesore e godinës. Në atë mëngjes të së hënës, prania e tij aty nuk tërhoqi vëmendjen e askujt, askush nuk u bë kureshtar ta pyeste përse rrinte duke prerë gozhdë jashtë në atë ditë të ftohtë. Këtë pyetje e gjykuan me vend t'ia drejtonin dy bashkëstudente të tij, të nesërmen, kur pasoi një ditë edhe më e ftohtë. Ai u ktheu një përgjigje të paarsyeshme:

- Amstel, kështu më pëlqen, dakord?

Vajzat ngritën supet si të donin t'i thoshin:

- Epo mirë, meqë Amstel, rri këtu, prit gozhdë deri nesër në mëngjes!

Ndërsa ai tha me vete: "O Zot, pse janë kaq kureshtarë njerëzit, përse duan t'i marrin vesh të gjitha, përse nuk e lënë tjetrin të qetë, qoftë edhe të luajë mendsh, po të dojë?".

E pamundur të mësohej me idenë se e panjohura me sy të mëdhenj, të zinj, nuk ekzistonte. Disa ditë me radhë, pa e çarë kokën për figurën qesharake që mund të bënte duke pritur në hyrje të fakultetit, ai u përpoq ta gjente atë midis qindra studenteve. Që ai

ishte në kërkim të një vajze, të gjithë zunë ta merrnin me mend, nuk e shqetësonin më me pyetje, por askush s'mund ta përfytyronte se cila ishte vajza që ruante ai.

Provën e fundit në kërkim të saj e ndërmori të dielën e radhës, plot një javë pas takimit të tyre te lokali në qytezën e kioskave të parkut “Rinia”. Ndoshta i qe mbushur mendja gabimisht se ajo studionte për gjuhë gjermane. Ajo mund të studionte për diçka tjetër, në një fakultet tjetër, dhe mbante parasysh pikërisht këtë fakultet tjetër, kur i kishte thënë të takoheshin atje. Me shpresë të gjallëruar befas, të dielën e radhës ai vendosi të shkonte te lokali në fjalë. Këtë vendim e përforcoi një zhvillim jo i zakonshëm. Natën, para se të gdhiehej e diela, ajo iu shfaq në ëndërr dhe e ftoi të bënin dashuri.

Ai zuri vend në të njëjtën tryezë pranë trungut të trashë të pemës, ende i përpirë nga skena erotike me vajzën e panjohur. Një portret fizik të saj të atyre ditëve, do ta bënte pak a shumë kështu:

“E veshur me rroba dimërore, ajo duket si çdo vajzë e zakonshme e epokës globaliste, nëpër udhëkryqet e botës. Një palë xhinse, çizme të larta, triko me fyt, sipër trikos një xhup i bardhë. Kjo ngjyrë i shkon me flokët e zinj, të lëshuar, fytyrën e pastër, ku ca sy të mëdhenj po aq të zinj sa flokët të vështrojnë me

një lloj habie, ndërsa buzët i rrinë vazhdimisht të kuqe, të thuash se tërë kohës i kafshon për të joshur dikë”.

Mirëpo ai nuk kishte ende ndonjë ngacmim për të ndërtuar një portret fizik të saj. Në natën e kalimit nga e shtuna tek e diela, ajo i qe shfaqur e mbështjellë me një pelerinë të bardhë, në një mjedis që i ngjante një amfiteatri, ku ai s`po e merrte vesh përse ndodhej.

Ja sqaroi ajo. Ata po luanin në atë skenë rolet kryesore të një tragjedie të lashtë. Kur ai e pyeti se cilën tragjedi, ajo iu përgjigj se nuk e dinte, e për këtë ankoheshin edhe shikuesit, kërkonin me ngulm emrin e tragjedisë, njëherazi dhe emrat e tyre.

- Nëse këtu do të kishte një tabelë të zezë dhe shkumës, - u tha ajo shikuesve të paduruar, - unë do ta shkruaja emrin tim që ta mësoni, por ju s`jeni të denjë. Unë e di, fill pas kësaj do të nisni të shpifni kundër meje, të sajoni një mijë të zeza, siç e keni zakon, ngaqë jeni shpirtkëqij të pandreqshëm.

Dikush nga të pranishmit protestoi:

- Mbushuni që të dy, - ulëriu, - ne s`kemi nevojë të dëgjojmë leksione.

Në atë çast ajo e zuri për dore.

- Eja, - i mërmëriti misteriozisht, - mjaft u morëm me këta idiotë!

U futën në një kthinë prapa skenës. Aty bënë dashuri. Ajo këmbënguli të mos ia tregonte emrin, edhe pasi bënë dashuri.

Ai qëndroi gjatë në tryezën pranë trungut të pemës, duke përgjuar se mos tutje, nga poshtë shkallëve, do të mbinte e do të shfaqej në lokal vajza e panjohur, tashmë aspak e panjohur për të. Ajo nuk erdhi.

Tek rrinte i përhumbur, ende në krahët e ëndrrës erotike, e ngacmoi një pandehmë. Në vend të saj mund të mbërrinte dikush tjetër, i lidhur virtualisht me praninë e saj, për shembull Inatçori. Mirëpo gjatë gjithë atyre ditëve që priste në hyrje të fakultetit - u ndie i sigurt për këtë - sytë nuk i kishin zënë as Inatçorin.

Në vazhdim e vërtetoi, edhe ai tip që zhdukur.

*H*oteli “Elsinor” ngrihet në rrëpirën e një kodre me pisha, pranë buzës së detit, në një gji të njohur me emrin “Gjiri i Kurvave”. Banorët aty rrotull, sigurisht, e njohin me emër tjetër, kështu ai është quajtur vonë, në kohët moderne, nga jovendasit, përfshirë edhe ata që e kanë bërë zakon të vijnë t’i kalojnë pushimet e verës këtu.

Asnjë lidhje midis tij dhe një vendi në kryeqytet, te kodrat pranë Liqenit Artificial, me të njëjtin emër, pra “Gjiri i Kurvave”, ku në fillim të viteve ’90 zuri të ndërtohej një godinë disakatëshe, për të cilën - bashkëkohësit duhet ta mbajnë mend - u fol se do të ishte një bordello, nisur dhe në përputhje me

toponimin e vendit. Ky variant u konsiderua i mirëqenë sidomos kur godina përfundoi dhe muret e jashtme u lyen në ngjyrë rozë. Pastaj u mësua se aty nuk do të vendosej një bordello, përkundrazi, ajo do të shërbente si strehë e një shkolle private për fëmijët e atyre që ua mbante xhepi, me emrin “Galileo Galilei”, e më tej, duke kaluar në duar të tjera qiramarrësish, ndryshoi edhe emrin, u quajt institucioni arsimor jopublik “Willson”, siç vazhdon të quhet edhe sot.

E vetmja gjë e përbashkët midis këtyre dy vendeve larg njëri-tjetrit është se në të dyja rastet, nuk dihet për ç’arsye, të zhvendosur aq shumë në hapësirë, janë quajtur me të njëjtin emër: “Gjiri i Kurvave”. Disa, për hir të pastërtisë gjuhësore, nuk përdorin fjalën “kurvë”, e kanë më për mbarë të thonë “Gjiri i Lavireve”.

Në pikëpamje estetike gjiri i kurvave apo i lavireve në breg të detit, është një kryevepër e natyrës. I vogël, me një plazh rëre në formën e një harku të shtrirë rrethi, në një ngjyrë blu të thellë për shkak të thellësisë së menjëhershme të ujërave, ai hapet deri në horizont, duke mrekulluar çdo kalimtar që e sheh nga lart kur kalon atypari, nëpër rrugën te qafa e kodrës. Dikur zonë e ndaluar ushtarake, kur u shpall zonë e lirë, gjiri la pa frymë me bukurinë e rrallë këdo që s’kishte dijeni për ekzistencën e tij. Me të drejtë, çdo kalimtari, qysh se u lejua

qarkullimi, nuk mund të mos i ndizej fantazia dhe të përfytyronte aty një pikë turistike.

Dora-dorës, bashkë me fantazinë, u zgjuan lakmitë. Në arkivat e një vargu gjykatash të shkallëve të ndryshme, që nga ato të periferisë e deri në qendër, ruhen pirqje dosjesh ku mbyllen përplasjet dramatike midis atyre që mëtuan shumë shpejt pronësinë mbi toka të gjirit, çka iu njoh vetëm disa personave, banorë të fshatit lart, përtej rrugës, rreth gjysmë ore në këmbë prej andej, apo pinjollë të familjeve të ndryshme, të larguar e të vendosur në kryeqytet prej kohësh. Këta u treguan më të zotë, ia dolën të paraqisnin dokumentacionin e duhur, me dëshmi të vjetra e të reja, të vërteta apo të rreme, duke shkaktuar pakënaqësi e smira të përbindshme tek ata që e panë veten të djegur në një histori më se dhjetëvjeçare, e mbetën me gisht në gojë, të bindur më shumë se kurrë për korrupsionin e gjykatave dhe padrejtësinë e luajtur në kurriz të tyre. Nga ana tjetër, gjatë më se dhjetë vjetëve, u regjistruan tri vrasje, të cilat njerëzit i lidhën me përplasjet për të njëjtin terren të gjirit, më i madhi e më i lakmuari nga të gjithë, falë cilësive dhe pozicionit të favorshëm.

E para nga këto vrasje, kur sapo kishte nisur të qarkullonte emërtimi “Gjiri i Kurvave”, u regjistrua si aksident me makinë, gremisje në humnerë për mosfunksionim frenash apo humbje të kontrollit të automjetit, arsye

që nuk bindën askënd. E dyta, pak vite më vonë, nuk la shteg për ekuivok, u krye me mjetin më frikësues ndaj mëtuesve të mbetur kokëfortë. Njëri prej tyre, ai që mendohej se i kishte të gjitha shanset për ta fituar betejën gjyqësore, u hodh në erë në makinën e tij me anë të një bombe të shpërthyer në largësi me telekomandë. Vrasja e tretë, simetrike me të dytën, por më spektakolare, ndodhi në zemër të kryeqytetit. Pronarin e hotelit “Elsinor”, të saponduartuar mbi atë terren, pronësia mbi të cilin më në fund i qe njohur zyrtarisht, e hodhën në erë po me telekomandë në kabinën e ashensorit vetëm pak ditë para përrimit, tek ngjitej në katin e shtatë të një pallati, ku strehohej larg syve të njerëzve me të dashurën. Ekzekutimi i çiftit, i konsideruar i tipit mafioz, mbylli serinë e vrasjeve për zotërimin e gjirit, të paktën përkohësisht, kështu u fol.

Inspektori Kurti mbërriti atje të nesërmen e bisedës me shefin, rreth mesditës, pas një udhëtimi prej dy orësh. Hoteli iu shfaq tutje, me të marrë kthesën te qafa e kodrës, dhe ai e ndaloi makinën në anë të rrugës. Kishte qenë këtu për herë të fundit nëntë vjet të shkuara, në të njëjtën kohë me një grup hetimor, ngarkuar me zbardhjen e vrasjes së të quajturit Gazmir Limoni, biznesmen, personazh i njohur dhe i përfolur, me lidhje në sferat e larta të politikës.



Atëherë, atë grup hetuesish e kryesonte një person i ri në moshë, që sapo kishte përfunduar një specializim profesional në USA. Me sens humori të zhvilluar, dosjen në fjalë, në një rreth të ngushtë, ai e paskej quajtur “Dosja e Gjirit të Kurvave”. Ndonëse zyrtarisht ajo njihej me emër tjetër, për forcë zakoni çështja zuri të njihej nga të gjithë me këtë etiketë, pra “Dosja e Gjirit të Kurvave”. Shumë shpejt kjo mbërriti në faqet e shtypit dhe u konsiderua skandal. Krahu me të cilin Gazmir Limoni ose Gazi, siç e thërrisnin miqtë e të afërmit, kishte pasur lidhje të forta, i dha ngjyrim politik, për të njollosur figurën e të ndjerit, çka, megjithatë, nuk mundi të pengonte askënd për ta dalluar çështjen ashtu siç e kishte cilësuar qysh në fillim me një humor të zi, kryetari i grupit.

Inspektori u përthith për ca çaste nga peizazhi. Çfarëdo ndryshimesh që të kishin ndodhur gjatë nëntë vjetëve, gjiri mbetej po ai, edhe pse, këndeje brezit të bardhë të plazhit, midis gjelbërimit, shquheshin fragmente ndërtimesh të vonshme. Hoteli “Elsinor”, më i veçanti për shkak të arkitekturës së tij, që kërkonte shëmbëllimin me një kështjellë mesjetare në miniaturë, mbetej gjithashtu po ai, edhe pse ngjyra e hirtë e mureve, dikur larg asaj të dëshiruar, ndërkaq, nën efektin e elementëve të natyrës, dukej sikur vërtet i përkiste një epoke tjetër. Për këtë inspektori

u bind pasi përshkoi një rrugë të ngushtë në rrëpirën e kodrës, të asfaltuar, dhe u gjend përballë kështjellës.

Dikush nga grupi i atëhershëm hetimor, nisur nga viktimat që lidheshin me këtë ngrehinë të ndërtuar në një kohë rekord prej vetëm dy vjetësh, po të mbaheshin parasysh vështirësitë e terrenit dhe karakteri special i punimeve, ishte shprehur se edhe në këtë rast qe ruajtur riti i traditës së lashtë të flijimit. Me qëllim që muret të ngriheshin sa më të fortë, ishte dashur të njomeshin themelet me gjak, plot tri vrasje. Kolegët iu kundërvunë, asnjë ngjashmëri midis këtyre vrasjeve dhe ritit të lashtë. Duke këmbëngulur në të vetën, tjetri u kishte kujtuar kolegëve se, sidoqoftë, edhe në këtë rast, ashtu si në legjendën e Rozafës, nuk mungonte femra e flijuar, e dashura e biznesmenit. Ndryshonte vetëm forma, thelbi mbetej po ai.

Për zotin Kurti, alergjik ndaj fluturimesh të tilla, çështja paraqitej banale, mizorisht. Vrasjet formonin hallkat e një zinxhiri të vetëm, çka nuk u provua kurrë, dhe dosja mbetej e hapur sot e kësaj dite. Larg kamerave pranohej nga të gjithë, të paktën vrasja e dytë duhej shënuar në llogari të Gazmir Limonit. Ndërsa hedhja në erë e këtij të fundit u duhej faturuar personave profesionistë, të paguar kësaj radhe nga të afërm të viktimës pararendëse.

“Një fiasko, - mendoj inspektori, tek vështronte ngrehinën e çuditshme, - një fiasko e plotë...”

Jo fort e qartë se ç’pati parasysh me këto fjalë, përfundimin dikur në qorrsokak të punës së grupit, apo të ashtuquajturën kështjellë, majë së cilës shënohej me shkronja të mëdha prej tubash neoni “Hoteli Elsinor”.

Pranë shkallëve të gurta që të ngjitnin drejt hyrjes, atij iu duk sikur pas nëntë vjetësh ndodhej aty për të vazhduar një hetim të lënë në mes. Këtë përshtypje ia përforcuan edhe dy luanë, po prej guri, që bënë rojë prej nëntë vjetësh, përpara shkallëve, në të dy anët, në pozicion simetrik ndaj njëri-tjetrit. Ai mendoj se nuk do të ishte keq të dilte me këtë rast në fotografi me secilin prej tyre, siç kishin bërë nëntë vjet të shkuara, një javë para se të hidheshin në erë, Gazmir Limoni me të dashurën. Fotografitë e vetme këto, ku bashkë me bosin pozonte femra e përfolur.

Një enigmë e mbështillte ekzistencën e saj. Gazmir Limoni, i martuar, me dy fëmijë, për arsye të ndryshme që kujdesur ta mbante të fshehtë lidhjen e tyre. Mirëpo tjetra paskej qenë aq e bukur sa bosin, i njohur për dobësinë e tij ndaj femrave të bukura, nuk do t’i bënte ballë tundimit për t’u shfaqur me të në publik. Përfundimi: nuk ishte ai që i shmangte këto dalje, përkundrazi, ishte ajo, femra enigmatike që nuk jetonte fare në Shqipëri.

Dhe, në përputhje me shprehjen sipas së cilës kur nuk shkon Muhameti te mali, shkon mali te Muhameti, pra shkonte bosin tek ajo. Diku, në Danimarkë.

Në këtë pikë enigma ndërlikohej. Askush nuk mund të thoshte se prej sa kohësh ndodhej ajo në Danimarkë, ku ndodhej, me se merrej, për ç'arsye u shmangej syve të njerëzve, nuk i dihej as emri, e këto çuan në krijimin e një legjende.

Sipas variantit zyrtar, ajo ishte rreth njëzet e pesë vjeç dhe nuk qenkej gjetur asnjë lloj dokumenti, që do të mundësonte identifikimin e saj. U gjetën disa fotografi të ditëve më të fundit, në prag të ekzekutimit, njëra prej tyre iu dha shtypit, duke sjellë një stuhi spekulimesh. Këto nisën pas publikimit të fotografisë nëpër gazeta e televizion, dhe individë të ndryshëm e njohën atë me emrin Lola Duka, një vajzë vërtet e zhdukur prej disa vitesh, pa lënë gjurmë. U paraqitën edhe prindërit e vajzës së zhdukur Lola Duka, e këtu nisi ngatërresa e madhe. Ata e panë në morg trupin e pajetë, u mbytën në lot, dhe në fund bënë deklaratën më të papritur. E vrara ngjante vërtet me vajzën e tyre, por nuk ishte ajo. E bija, përveçse më e re, vinte më e vogël në trup, mbi të gjitha të vranës i mungonte një nishan në kraharor, e ëma do ta njihte të bijën falë atij nishani edhe midis një mijë të tjerash.

- Jo, trupi i pajetë nuk ishte i saj, - thanë ata të sigurt, duke u mbytur sërish në lot.

Spekulimet vazhduan gjatë, po ashtu dhe hamendjet. U akuzuan organet përkatëse për paaftësi, deri në mbulim të qëllimshëm të të dhënave, e pamundur të mos gjendej asnjë fakt rreth të panjohurës, ajo nuk figuronte qoftë edhe me emrin Lola Duka në asnjë pikë hyrëse kufitare. Disa hollësira mbase i dinte, ose duhej t'i dinte, njëri nga rojat e afërta të bosit, mirëpo ky nuk zbuloi asgjë përveç një të vërtete jodomethënëse. Gazmir Limoni e paskej njohur të dashurën në një udhëtim të rastit në Danimarkë. Qysh atëherë udhëtimet e tij në atë vend, me të cilin nuk e afronte ndonjë marrëdhënie biznesi, ishin bërë të shpeshta.

U përfol edhe diçka tjetër. Idenë për të ndërtuar te Gjiri i Kurvave një hotel dhe ta quanin “Elsinor”, Gazmir Limonit ia paskej shtënë në kokë e dashura. Këtë e lidhnin me një qëndrim të tyrin në hotelin-kështjellë me emrin emblemantik “Elsinor” në Danimarkë. Dikush, i afërt i bosit, pretendoi se kishte parë fotografi të tij me të panjohurën përpara hotelit të famshëm. “Më shumë se ide, - tha dikush tjetër po i afërt, - kjo kishte qenë një dëshirë, një tekë femërore, ndërsa hoteli një dhuratë e bosit ndaj të dashurës”.

Përtej këtyre fantazive, inspektori Kurti pranonte një të vërtetë: e dashura e Gaz

Limonit kishte qenë mjaft e bukur. Këtë e dëshmonin fotografitë te luanët e gurtë. Pranë Gazit shtatlartë, në atë kohë rreth të dyzetave, ajo dukej shumë e re. Gazi mbante pantallona verore të bardha, këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë blu, një kasketë po të bardhë, prej së cilës i dilte një cullufe flokësh. Ajo ishte e veshur me një fustan të hollë, të zi, paksa të hapur, që lejonte shfaqjen e gjinjve. Edhe sot e kësaj dite inspektorit i mbeteshin të pashlyer në kujtesë sytë e saj. Ca sy të mëdhenj, të zinj, drejtuar tek aparati fotografik me një lloj shpërqendrimi, të thuash se po e merrnin befasisht, pa dëshirën e saj. Duhej të kishte qenë një shkrepje automatike, pa praninë e ndonjë të treti, e rregulluar qysh më parë nga ndonjëri prej tyre.

Atëherë, këto fotografi, të nxjerra nga një aparat i gjetur në zyrën e Gazmir Limonit, e çuan inspektorin të ndërtonte, përkundër legjendave, një variant më tokësor për natyrën e marrëdhënies së çiftit. Pas dukjes romantike, një bashkëpunim i mundshëm në trafikë të paligjshme. Kujdesi i llogaritur i asaj femre të bukur, me sy të mëdhenj të zinj, për t'u fshehur me çdo kusht, këtu të çonte. Mirëpo ja nga ngjyrimet politike që po i visheshin ngjarjes, ja nga mungesa e provave dhe moskapja e ekzekutorëve, ja ngaqë tepër cinike ndaj femrës së vrarë, këtë teori inspektori nuk guxoi t'ia shprehte askujt tjetër përveç vetvetes.

Ai qëndroi në kështjellë tri ditë. Do t'i mjaftonin ndoshta tri orë për të kryer një investigim fillestar. Pastaj të kthehej në Tiranë, të nesërmen të shkonte në zyrë, të zinte vend pranë tryezës së punës dhe, para se të kalonte nga shefi, t'i bënte një raport të shkurtër bashkëshortes. Kështu e kishte menduar, megjithëse, në përputhje me një zakon të vjetër, mori me vete në çantë sende të përdorimit vetjak për tri ditë.

Me fjalët “investigim fillestar” ai kuptonte një kontroll të regjistrit të klientëve-bujtës në kështjellë, të paktën gjatë dy viteve të fundit. Meqë sipas informacionit vrasja pritej të ndodhte në këtë mjedis, do të thoshte se ky ishte një vend i parapëlqyer për viktimën. Duke shpresuar që në këtë hotel jo si gjithë të tjerët, regjistri i klientëve të ishte mbajtur i rregullt, midis tyre të veçonte personat e quajtur “VIP”.

Me këtë ide në kokë ai u paraqit te recepsioni në hollin e hotelit. Ky ishte i madh, shtruar me pllaka mermeri të gjelbër. Ajo që binte në sy, përveç ca perdeve të rënda mbi dritaret rreth e rrotull, në një të kuqe në ngjyrën e gjakut, ishin dy armatura kalorësish mesjetarë, më të larta se një bojë njeriu, në të dy anët e recepsionit, në pozicion ceremonial, me ca heshta të gjata. Përtej armaturave, në banak e priti një djalë rreth të njëzetave.

Puna e recepsionistit duhej të ishte kalimtare për të, kështu mendoi inspektori,

dhe kështu doli. Më pas, i riu i shpjegoi se ishte student, ndiqte fakultetin juridik, këtu vinte vetëm gjatë verës për të qëndruar deri në fillim të shtatorit. Inspektori i ndryshoi planet kur i riu e pyeti ç'dëshironte. Nga një lajthitje e çastit, ai i bëri pohimin më të papritur, domethënë dëshironte të rrinte në hotel nja dy ditë. Dhe shtoi diçka që truri i tij e prodhoi aty për aty: do t'ia dinte për nder po t'i jepte një dhomë, në një nga tri kullat e kështjellës.

- Jeni me fat, zotëri, - ia ktheu djaloshi, - njëra nga këto dhoma sapo u lirua sot në mëngjes. Klientët i kërkojnë shumë, ka ndër ta që vijnë për t'u vendosur pikërisht në ndonjërin prej tyre, por ato janë vetëm tri, s'kemi mundësi t'i kënaqim të gjithë... Një dokument identifikimi, ju lutem, çfarëdo!

Tepër vonë për ta ndrequr lajthitjen, do të ishte e pakuptimtë. Këtë i vuri në dukje edhe një burrë i pashëm prapa krahëve të djaloshit, që po e shihte buzagaz qysh se i qe afruar receptionit. Ai i foli nga një fotografi në faqen ballore, midis shumë fotografive të tjera, në qendër të tyre, një pjesë me figura të njohura për inspektorin, të vendosura në një pozicion ku në çdo hotel të botës, zakonisht gjenden të ndarat e çelësave.

Me një lloj qesëndie, burri i bëri edhe një vërejtje paralajmëruese. Nëse pas nëntë vjetësh kishte ardhur këtu të ringjallte një çështje të varrosur, gabohej, ai mbahej i fortë!



Inspektori sajoi një buzëqeshje dhe deshi ta qetësonte. Që mbahej i fortë, as që e vinte në dyshim. Sa për dosjen “Gjiri i Kurvave”, të mos merakosej, nuk e çante më kokën njeri. Ai vërtet kishte ardhur për diçka të ngjashme, por kjo vështirë të lidhej me hesapet e tij të vjetra.

Deshi t’i thoshte gjithashtu se përjetonte një befasim, as të këndshëm as të pakëndshëm, që pas nëntë vjetësh e gjente buzagaz, rrethuar mes miqsh të fuqishëm. Dhe në fund t’i shprehte befasimin më të madh, përballja në recepsion me këtë djalin e sjellshëm, student në fakultetin juridik, tiparet e rregullta të të cilit, e gjithë fizionomia, dëshmonin se si qëndronin punët.

Inspektori iu duk e tepërt dhe e kotë ta pyeste djaloshin nëse kishte ndonjë lidhje midis tij dhe burrit të fotografisë. Duke mos dashur të krijonte keqkuptime, ai nxori kartën e identitetit për t’u regjistruar. Pastaj dokumentin e shërbimit, e sqaroi kush ishte dhe i kërkoi t’i vinte në dispozicion regjistrin e klientëve bujtës në kështjellë gjatë dy viteve të fundit.

Në fytyrën e tjetrit u derdh një kuqëlim i shpjegueshëm. Ai e mori me mend ekuivokun e krijuar në kokën e të riut dhe u përpoq ta qetësonte. Arsyeja për të cilën ia kërkonte regjistrin nuk lidhej me administrimin e hotelit, ishte tjetër, ai s’duhej të merakosej, as të bëhej kureshtar.

I riu nuk e zgjati. I kërkoi ta priste në banak për pak minuta, se ku vajti dhe u kthye prej andej me një bllok të formatit të madh, me kapakë të trashë, mbi të cilin shënohej “Regjistri 2010”. Këtë e shoqëroi me një bllok të ngjashëm, të të njëjtit format e kapakë të trashë, mbi të cilin shënohej “Regjistri 2011” ku, i fundit në listën e klientëve, tashmë figuronte emri i tij.

Gjithnjë i sjellshëm dhe tërë kohën me atë kuqëlimin në fytyrë, djaloshi i tha se po të dilte nevoja mund t’i vinte në dispozicion edhe regjistra të viteve të mëparshëm. Për hollësira të tjera, mund të bisedonte me administratorin e hotelit, atë ditë ai nuk ndodhej, por do të vinte të nesërmen. Ky qenkej i ungji, banonte diku aty rrotull dhe e drejtonte hotelin qysh nga fillimi, prej nëntë vjetësh. Hëpërhë, zoti Kurti kishte vetëm një ngut: të zhytej në regjistrat e klientëve. Të tjerat mund të prisnin deri nesër dhe aq më mirë që administrator qenkej qysh nga fillimi, prej nëntë vjetësh, një njeri i familjes.

Në lartësinë e detyrës së tij, studenti i fakultetit juridik e pa me vend t’i sqaronte edhe ndonjë hollësi praktike, për shembull, këtu mëngjesi përfshihej në çmimin e dhomës, shërbehej nga ora gjashtë deri në dhjetë paradite, restoranti ndodhej në katin e dytë, po atje kishte edhe një kafe-bar, njëzet e katër orë “non stop”, si dhe një dyqan ku klientët mund të blinin sende të nevojshme për kohën

e qëndrimit atje. Përveç këtyre, inspektorit do t'i interesonin një varg hollësish plotësuese, te të cilat të riut nuk mund t'i shkonte mendja. Hëpërhë, edhe këto mund të prisnin deri nesër, me një administrator pjesëtar të familjes, ai do të mund merrej vesh më lehtë.

I kërkoi tjetrit vetëm një shërbim të fundit, ta shoqëronte deri lart në dhomë. Nëntë vjet të shkuara, ai kishte mundur t'u hidhte një sy mjediseve të katit të parë dhe të dytë, ku pjesëtarët e grupit hetimor ishin strehuar për të marrë në pyetje dëshmitarë vendas. Tani nuk i kujtohej asgjë, përveç një fakti, atëherë funksiononte një ashensor. Ky funksiononte gjithnjë, por ndryshe nga ç'i propozoi djaloshi, ai parapëlqeu të ngjiteshin në këmbë.

Shkallët gjendeshin në anën e kundërt të hollit. Pas dy sheshpushimesh, ato të nxirrnin në katin e dytë, fare pranë vendit ku hapej ashensori. Nëse do të vazhdoje ngjitjen për në katin e tretë prapë me shkallë, duhej të shkoje sërish në anën e kundërt dhe pas dy sheshpushimesh të tjera, mbërrije në katin e tretë. Më tej ashensori nuk shkonte dhe ngjitja për në dhomën e vetme të secilës prej tri kullave kryhej përmes shkallëve. Këto i kujtuan inspektorit formën e shkallëve të xhamisë së kryeqytetit, ku qe ngjitur një herë të vetme në jetën e tij, por me një hapësirë më të gjerë dhe me lartësinë e një kati të zakonshëm.

Në krye të spirales ishte një derë. Djaloshi rrotulloi çelësin në bravë, hapi derën, e ftoi të futej brenda, vetë u fut pas tij dhe vendosi dy regjistrat bashkë me çelësin mbi një tryezë aty pranë. Më tej i tregoi të veçantën e dhomës. Përmes një dore ajo komunikonte me një kthinë, ku një palë shkallë prej hekuri të ngjisnin pranë një kapanxhe në tavan dhe prej andej dilje te bedenat e kullës. Atje të shpalosej një pamje fantastike, zotëria do ta shihte vetë.

Nuk mbetej më asgjë për të thënë. I uroi vizitorit të heshtur një pasdite të këndshme dhe e gjykoi të udhës të largohej, pa harruar t'i shtronte një kërkesë. I lutej zotërisë që me të mbaruar punë me regjistrat, t'i zbriste poshtë, në reception.

Zoti Kurti mbeti për disa çaste në mëdyshje, nuk po vendoste nga t'ia niste, të merrej me regjistrat, apo të bënte një dush. Apo, siç e fshiku një ide, t'i linte edhe regjistrat, edhe dushin. Klient në kështjellën e bosit, të ndiqte udhëzimet e të birit, të kalonte në kthinën përbri, prej andej në bedenat e kullës dhe atje të gjente një përgjigje për një pyetje që po i vërtitej në kokë qysh se e kishte kuptuar se studenti i fakultetit juridik ishte djali i Gaz Limonit. Ç'mendim mund të kishte i biri për të atin?

Ai u prir të kryente ca veprime të tjera, automatike. Mori çelësin mbi tryezë dhe vajti

kyçi derën e dhomës. Hoqi revolverin, futur në këllëf, kapur te rripi i pantallonave, në ijën e djathtë, dhe e vendosi te koka e krevatit, nën jastëk. Kostumin veror prej stofi të lehtë e vari në kremastar, kremastarin, në mungesë të dollapit të rrobave, në një musëndër. Nga çanta e shërbimeve, prej lëkure të trashë ngjyrë kafe - e përdorte prej njëzet vjetësh - nxori veglat e rojës dhe një palë lepitka, i kënaqur që i kishte marrë me vete. Me ç'pa, në banjë lepitkat mungonin dhe bezdia e tij më e madhe nëpër hotele ishte kur i harronte në shtëpi. Pas këtyre veprimeve automatike, gjithnjë me pikëpyetjen at-bir në kokë, ai bëri një dush. Atëherë pikëpyetja u përthith brenda tij dhe ai u ndie i aftë të zhytej te regjistrat.

Kjo punë i mori shumë më tepër kohë nga ç'kishte parashikuar, plot pesë orë, përfshirë këtu një numër pushimesh të shkurtra. Dhe një pushim rreth gjysmë ore, kur u ngjit te bedenat e kullës, duke lënë në dhomë, të mbyllur në blloqet me kapak të trashë, një varg emrash. Këtë varg dikush nuk do të ngurronte ta quante pambarimisht të gjatë. Inspektori s'do të shprehej kështu, logjika matematike nuk do t'ia lejonte. E shumta, si lexues i fortë, i ndikuar nga librat, në ato çaste do të mund ta krahasonte veten me një zhytës në thellësi ujërash të turbullt, ku nuk ka asgjë për të parë, asgjë për të zbuluar, dhe

i lodhur ngjitet në sipërfaqe. Atje heq maskën, mbushet me frymë, i ndërgjegjshëm se shumë shpejt do t'i duhet të zhytet prapë, në kërkim të diçkaje që as vetë nuk e di çfarë është, me shpresë se më në fund do ta gjejë. Por ai ishte njeri racional, në rastin e tij fluturime të tilla përjashtoheshin.

Në mbyllje të kërkimit pesorësh, ai ia lejoj vetes sërish kënaqësinë për të dalë te bedenat e kullës. Po binte muzgu dhe frynte erë, megjithatë në plazh lëvrinin ende pushues. Secilit prej tyre, mendoi inspektori, i përkiste njëri nga emrat e renditur në faqet e fundit të bllokut të dytë. Emra të zakonshëm, shoqëruar nga mbiemra po aq të zakonshëm. Edhe sikur vrasësi të vërtitej tashmë aty rrotull, qoftë dhe midis popullit lëvritës në plazh, atë natë - atij i qe mbushur mendja se vrasja do të kryhej gjatë natës, pavarësisht faktit se ishte ende fund gushti dhe deri në shtator, kur pritej të ndodhte vrasja e paralajmëruar, mbeteshin disa ditë - asnjëri prej tyre nuk do të vritej. Të gjithë ata mund të rrinin të qetë, atë natë në kështjellë s'do të kryhej ndonjë vrasje. Për një arsye të thjeshtë. Asnjëri prej tyre, sado i rëndësishëm në vetvete, nuk ishte VIP. Të gjithë përfshiheshin në kategorinë "anonimë".

Të parët që përjashtoi nga lista e personave të mundshëm për t'u vrarë, ishin këta, anonimët. Po të fliste me gjuhë statistikore, ai do të mund të thoshte se nëntëdhjetë e pesë